



Dokument i Politikave:

Vlerësimi i implementimit të politikave të rendit publik dhe të sigurisë në kontekstin e procesit të liberalizimit të vizave për Kosovën

Autori:

Mentor VRAJOLLI

Mbështetur nga:

European Fund for the Balkans

Bringing the Western Balkans closer to the European Union

Ky Projekt është mbështetur nga "Fondi Evropian për Ballkanin". Inicativë kjo e Fondacionit Robert Bosch, Compagnia di San Paolo, Fondacioni ERSTE and Fondacioni King Baudouin, kordinuar nga NEF".

Prishtinë, Kosovë

1 Nëntor 2012

PËR AUTORIN:

Autori i këtij punimi është Mentor VRAJOLLI, Hulumtues i lartë /Sekretar në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS). Z.Vrajolli është një prej hulumtuesve dhe anëtarëve më eminent të QKSS. Deri më tani ai është autor dhe bashkë-autor i një numri publikimesh të ndryshme, si dhe njëkohësisht ka qenë i involvuar në projekte të ndryshme të udhëhequra nga QKSS e të cilat kanë pasur të bëjnë me avokim (për më shumë detaje ju lutem shihni ueb-faqen e QKSS: www.qkss.org).

GRUPI HULUMTUES:

Mentor VRAJOLLI, Hulumtues i Lartë

Skender PERTESHI, Hulumtues

Sofije KRYEZIU, Hulumtuese

SHQYRTIMI DHE EDITIMI:

Florian QEHAJA, Drejtor Ekzekutiv

Armend MUJA, Udhëheqës i Programeve dhe Hulumtimeve

© TË DREJTAT E AUTORIT

TË GJITHA TË DREJTAT NË LIDHJE ME KËTË HULUMTIM I TAKOJNË QENDRËS KOSOVARE PËR STUDIME TË SIGURISË (QKSS)

ADRESA:

SYLEJMAN VOKSHI, 13/3

10000 PRISHTINW, KOSOVW

E-MAIL ADRESA: INFO@QKSS.ORG

UEB-FAQJA ZYRTARE: WWW.QKSS.ORG

TEL: +381(0) 38 221 420

Të gjitha pikëpamjet e shprehura në këtë dokument të politikave janë të shprehura nga autori i këtij hulumtimi dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht qendrimet e donatorit. Verzioni origjinal i studimit është në anglisht kurse verzionet në gjuhët shqipe dhe serbe janë përkthim.

PËRMBAJTJA

LISTA E SHKURTESAVE	5
Përmbledhje	7
Metodologjia	9
NOTIMI MBI IMPLEMENTIMIN E SECILËS STRATEGJI.....	11
I. KENDVESHTRIMI I LIBERALIZIMIT TE VIZAVE	14
1.1. HISTORIKU I RENDIT PUBLIK DHE POLITIKAVE TE SIGURISË: PASQYRIMI I PROCESIT TE LIBERALIZIMIT TE VIZAVE NE BALLKANIN PERËNDIMORE.	14
1.2 SFIDAT POLITIKE TE KOSOVËS NE DIALOG TE STRUKTURUAR TE LIBERALIZIMIT TE VIZAVE	16
1.3 IMPLIKIMET E BRENDSHME TE DIALOGUT TE VIZAVE ME KOSOVËN (2009– 2012)	17
II. IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE TE RENDIT PUBLIK DHE SIGURISË.....	18
2.1. IMPLEMENTATION OF INTEGRATED BORDER MANAGEMENT POLICIES IN KOSOVO	18
2.2. IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE QEVERITARE NE PARANDALIMIN E KRIMIT TE ORGANIZUAR, KORRUPSIONIT, DHE TERRORIZMIT	22
A. PARANDALIMI DHE LUFTIMI KUNDËR KRIMIT TE ORGANIZUAR.....	22
B. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË	30
C. PARANDALIMI DHE LUFTIMI KUNDËR TERRORIZMIT	33
BIBLIOGRAFIA	35

LISTA E SHKURTESAVE

AKI	Agjencia e Kosovës për Inteligjencë
B&H	Bosnja dhe Hercegovina
BE	Bashkimi Evropian
BP	Ballkani Perëndimor
DAT	Departamenti i Anti-Terrorizmit
DFAC	Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura
DSAK	Departamenti i Specializuar për Anti-Korrupsion
EULEX	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
Eurojust	Njësia Gjyqësore për Bashkëpunim e Bashkimit Evropian
Evropol	Zyra e Policisë Evropiane
FYR	Ish Republika Jugosllave
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
Interpol	Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale
KB	Kombet e Bashkuara
KDI	Instituti Demokratik i Kosovës
KFOR	NATO Forca e Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit

MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
PK	Policia e Kosovës
PPSM	Politikat e Përbashkëta për Siguri dhe Mbrojtje
QKSS	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
SHFSV	Shërbimi Fito-Sanitar dhe Veterinarë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VFTK	Veprimet Financiare të Task-Forcës

Përmbledhje Ekzekutive

Procesi i liberalizimit të vizave ishte pjesë e ofertës për perspektivën evropiane të cilat iu prezantuan vendeve të Ballkanit Perëndimor (BP) gjatë Samitit të Selanikut në vitin 2003. Megjithatë, derisa të gjitha vendet e tjera të BP tashmë kanë lidhur marrëdhënie kontraktuale për liberalizimin e vizave me BE-në. Kosova fillimisht u la jashtë këtij procesi, pjesërisht për shkak të pasigurive politike rreth statusit dhe pjesërisht për shkak të mungesës së konsensusit të anëtarëve të BE-së rreth kësaj çështjeje. Që atëherë, shumica e vendeve të BP lëvizën shpejt dhe ndërmorrën reforma të ndryshme që ndërlidheshin me këtë proces. Kështu deri në vitin 2009, tre nga këto vende arritën të përmbyllin procesin e liberalizimit të vizave, ndërsa dy të tjera ju dha edhe një vit kohë shtesë për të adresuar mangësitë e mbetura. Në pamundësi për të qenë pjesë e procesit të njëjtë si rezultat i mungesës së dritës jeshile nga Komisioni Evropian, Qeveria e Kosovës në mënyrë të njëanshme nisi 'udhërrëfyesin' e saj ngajshëm sikurse vendet e tjera të rajonit – duke zbatuar qasje dhe strukturë të njëjtë të prioritetëve. Pavarësisht nga kjo, Kosova mbetet vendi i vetëm në rajon qytetarët e së cilës nuk janë ende në gjendje të udhëtojnë pa viza në BE.

Më në fund, në Qershor 2012 Komisioni Evropian zyrtarisht lansoi dokumentin "Liberalizimi i Vizave: Udhërrëfyesi për Kosovën". Kjo marrëveshje kontraktuale me BE-në kërkon angazhim nga të gjitha institucionet përkatëse në zbatimin e politikave në fushat e: dokumentet mbi sigurinë, politikat mbi kontrollimin e kufijve dhe migracionit, politikat e rendit publik, sigurisë, dhe të drejtave e lirive themelore. Në fakt, shtrirja dhe implikimet e Udhërrëfyesit për Kosovën janë po aq të gjera sa që pamundësojnë përfshirjen e të gjitha aspekteve të këtij dokumenti në një analizë të vetme. Andaj, ky studim do të fokusohet kryesisht në politikat e rendit publik dhe sigurisë. Për hartimin e këtij studimi është përdorur korniza metodologjike e zhvilluar bashkarisht nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe partnerët e saj në kuadër të konsorciumit rajonal të 'Think Tankeve' të titulluar "Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së Mirë në Sektorin e Sigurisë". Kjo metodologji ka marrë për bazë një sistem unik të notimit të kornizës ligjore dhe kapaciteteve implementuese. Në kuadër të këtij hulumtimi është vlerësuar shkalla dhe progresi i bërë nga Kosova në menaxhimin e integruar të kufirit, luftimit dhe parandalimin e krimit të organizuar, korrupsionit si dhe terrorizmit.

Ky studim tregon se korniza legjislative e Kosovës është kryesisht në përputhshmëri me *Aquis Communautaire* të BE-së. Po ashtu, ajo pjesë e legjislacionit e cila ka qenë deri më tani pak sa më problematike tash më është në fazën finale të miratimit apo është në pritje të hyjë në fuqi nga fillimi i vitit 2013. E gjithë kjo rritje e ritmit të aktiviteteve legjislative dhe përpjekjet për të çuar përpara procesin e zbatimit është duke ndodhur në gjithë periudhën e passhaplljes së Pavarësisë. Hulumtimi ynë ka identifikuar një numër të madh të draft ligjeve dhe strategjive të ripërtira të cilat janë duke u diskutuar, dhe që janë në fazat e fundit të miratimit të nga ana e Kuvendit të Kosovës. Përparim i theksuar është vërejtur në zbatimin e politikave në Menaxhimin e Integruar të Kufirit e po ashtu të atyre që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar ku ndër të tjera përfshihet trafikimi i qenieve njerëzore dhe drogës. Në anën tjetër, rezultate më të limituara janë arritur në përpjekjet institucionale për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Ndërkohë, përparimi në luftën kundër terrorizmit është matur në kuadër të kontekstit të konsolidimit të përgjithshëm të sektorit të sigurisë dhe sistemit të drejtësisë.

Kapitulli i parë i këtij studimi shqyrton kontekstin e liberalizimit të vizave dhe zhvillimet politike në përgjithësi. Kapitulli i dytë përfshin një analizë të gjerë të të arriturave në plotësimin e kornizës legjislative dhe ndërtimin e kapaciteve të duhura për zbatimin e kësaj kornize, në fushat e menaxhimit të integruar të kufirit, krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit.

Metodologjia

Gjetjet dhe vlerësimet e bëra në këtë studim janë të bazuara në metoda të ndryshme të grumbullimit të të dhënave. Studimi është bazuar kryesisht në gjetjet e stafit hulumtues, ku në raste të caktuara, janë analizuar edhe databazat statistikore të institucioneve përkatëse. Poashtu, gjetjet e këtij hulumtimi përfshijnë inpute nga intervistat e zhvilluara me pesëmbëdhjetë zyrtar përkatës si akterë kryesor si dhe nga përdorimi i metodave tjera hulumtuese siç është observimi pa-pjesëmarrje. Me fjalë të tjera, për hartimin e këtij hulumtimi janë konsultuar një numër i madh i akterëve përfshirë hartuesit dhe praktikuesit e politikave përkatëse, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe prania ndërkombëtare. Korniza metodologjike është e bazuar në metodologjinë e zhvilluar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), në bashkëpunim me qendra hulumtuese (think tank) tjera partnere nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, ndërsa si fokus hulumtimi ka matjen e politikbërjes dhe procesin e implementimit. Duke marrë për bazë këtë metodologji, së pari është vlerësuar shkalla e progresit në hartimin e politikave, dhe pastaj është analizuar progresi i arritur në implementimin e politikave dhe veprimeve të ndërmarra nga ana akterëve vendim-marrës në këtë drejtim. Detajet e gjera lidhur me kornizën metodologjike mund të gjenden në librin e botuar nga QKSS të titulluar "Monitorimi dhe Vlerësimi i Qeverisjes së Mirë në Sektorin e Sigurisë së Kosovës".

Duke pasur parasysh temën specifike që prek ky ky studim, ngjajshëm edhe këtu është vlerësuar progresi i arritur në nxjerrjen e legjislacionit përkatës si dhe në arritjen e kapaciteteve të mjaftueshme në implementimin e kriterëve për liberalizimin e vizave nga ana e institucioneve të sektorit të sigurisë. Sistemi i notimit ndërthen notat nga 1 (dobët) deri në 5 (shkëlqyeshëm) të cilat janë përdorur për të ranguar shkallën e progresit të arritur në këtë fushë. Arsyetimi i sistemit të vlerësimit është bazuar si më poshtë:

<p>NOTA 1</p>	<p>Korniza Ligjore dhe e Politikave</p>	<p><u>Treguesi kryesor është mos-ekzistimi i ligjeve dhe politikave bazë</u> (p.sh. nëse Ligji për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Kufijve janë miratuar).</p>
<p>Vlerësimi bazohet në kualitetin e normat ligjore, politikave dhe praktikën e implementimit</p>	<p>Implementimi dhe Kapacitetet Institucionale</p>	<p><u>Shpeshtësia, sasia dhe cilësia e praktikës së keqe</u>: Praktikave e përhapur keqpërdoruese. Ka mungesa të mëdha në zbatimin e ligjeve dhe politikave.</p> <p>Alokimin dhe menaxhimin jo-adekuat i burimeve materiale dhe njerëzore të nevojshme për zbatimin e ligjeve e të strategjive përkatëse.</p>
<p>NOTA 2</p>	<p>Korniza Ligjore dhe e</p>	<p><u>Tregues kryesor është ekzistenca e ligjeve dhe politikave</u></p>

Vlerësimi bazohet në kualitetin e normat ligjore, politikat dhe praktikën e implementimit	Politikave	bazë: Legjislacioni primar dhe politikat janë tashmë të miratuara.
	Implementimi dhe Kapacitetet Institucionale	<p><u>Shpeshtësia, sasia dhe cilësia e praktikave të këqija:</u> Ende ka kufizime sa i përket implementimit në praktikë dhe rezistencë të theksuar në futjen e praktika të mira. Praktika e mirë në zbatimin e ligjeve dhe politikave ende nuk është bërë një fenomen i rregullt.</p> <p><u>Burimet</u> ose nuk kanë qenë të ndara ose kanë qenë në sasi të pamjaftueshme, duke vënë në pah mungesën e burimeve materiale dhe njerëzore sa i përket zbatimit të ligjeve dhe politikave.</p>
NOTA 3 Vlerësimi bazohet në kualitetin e normat ligjore, politikat dhe praktikën e implementimit (minimumi i implementimit për 2 vite)	Korniza Ligjore dhe e Politikave	<u>Treguesi kryesor ekzistimi i ligjeve primare: Po ashtu,</u> legjislacioni dhe politikat e nevojshme ekzistojnë edhe në fusha të veçanta.

	Implementimi dhe Kapacitetet Institucionale	<p>Praktika e mirë – do të thotë se ekzistojnë ligje dhe politika që janë duke u implementuar për më së paku 2 vite. Ka ende raste kur shfaqen praktika të kufizuar në zbatimin legjislacionit dhe politikave përkatëse, megjithatë këto raste tashmë bëjnë përjashtim.</p> <p>Burime të caktuara janë alokuar në mënyrë që detyrat të jenë të deleguara në veçanti për të implementuar dispozitat e ligjeve dhe politikave përkatëse.</p>
NOTA 4	Korniza Ligjore dhe e Politikave	Të gjitha ligjet dhe politikat janë miratuar.

	Implementimi dhe Kapacitetet Institucionale	<p>Ka elemente të dukshme të cilat tregojnë se legjislacioni dhe politikat institucionale janë tashmë duke u implementuar pa hasur në vështirësi. Ka qëndrueshmëri të dukshme në zbatimin e ligjeve dhe politikave.</p> <p>Kapacitetet institucionale janë tashmë të konsoliduara dhe krejtësisht funksionale.</p>
NOTA 5	Korniza Ligjore dhe e Politikave	Të gjitha ligjet dhe politikat janë miratuar.
Vlerësimi bazohet në kualitetin e normat ligjore, politikave dhe praktikën e implementimit si dhe institucionalizimin e vlerave pozitive (më shumë se 6 vite për implementim)	Implementimi dhe Kapacitetet Institucionale	<p>Janë bërë përpjekje të konsiderueshme në zvogëlimin dhe eliminimin e çfarëdo mundësie për praktikë të keqe.</p> <p>Ekzistojnë prova të dukshme për implementimin adekuat të politikave përkatëse duke përdorur rregulla strikte me qëllim të eliminimit në tërësi të praktikave të këqija.</p>

NOTIMI MBI IMPLEMENTIMIN E STRATEGJIVE

Kriteri	Arsyetimi	Nota
Implementimi i Politikave për Menaxhimin e Integruar të Kufirit	<p>Korniza ligjore për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) tashmë është e kompletuar dhe është pothuajse në përputhje të plotë me <i>Acquis Communautaire</i> dhe normat e tjera ndërkombëtare. Gjithashtu, korniza për implementimin e politikave në nivel strategjik është tashmë e kompletuar dhe mjaft e avancuar.</p> <p>Të gjitha institucionet përkatëse për koordinimin e mekanizmave e MIK janë tashmë të kompletuara, falë punës së intensifikuar gjatë katër viteve të fundit ku vërehet një ngritje relativisht e kënaqshme</p>	3.5

	<p>në ngritjen e kapaciteteve. Personeli që punon në fushën e MIK është trajnuar profesionalisht, pajisur me pajisje teknologjike të avancuara, dhe me një përkushtim të theksuar në përmbushjen e detyrave të tyre. Megjithatë, edhe më tutje ekziston nevoja për përmiresimin e praktikave për implementimin e politikave të MIK. Në veçanti, ka nevojë për efikasitet më të madh nga ana e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, për të cilën situatë janë drejtuar shqetësime të ndryshme nga ana e BE-së në lidhje me implementimin e MIK.</p> <p>Nga aspekti i bashkëpunimit, Kosova është duke zhvilluar marrëdhënie të shëndosha bashkëpunimi ndër-kufitar me shtetet fqinjë si Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë (megjithëse me këtë të fundit ende nuk ka patrulla të përbashkëta të Policisë Kufitare). Bashkëpunimi ndërkufitar me Serbinë ende varet nga zhvillimet politike dhe nga vullneti i Serbisë për të implementuar marrëveshjet për MIK të arritur në Bruksel.</p>	
<p>Strategjitë për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar</p>	<p>Korniza ligjore për luftimin e krimit të organizuar është tashmë pothuajse e kompletuar. Miratimi i Kodit të ri Penal i cili do të hyjë në fuqi në vitin 2013 do të përmirësojë edhe më tej përpjekjet institucionale për të parandaluar dhe luftuar këto fenomene. Ndërkohë, miratimi i një ligji të veçantë kundër krimit të organizuar (që është përfshirë në agjendën legjislativë të Kuvendit të Kosovës) do të përmirësonte edhe më tej përpjekjet institucionale në këtë fushë, edhe pse sipas Udhërrëfyesit për Kosovën kjo nuk është një parakusht kur është fjala për implementimin e liberalizimit të vizave. Ndërkohë edhe korniza strategjike për luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar dhe të gjitha mekanizmat përkatës për luftimin e fenomeneve të krimit të organizuar janë tashmë të kompletuar.</p>	<p>3</p>
<p>Luftimi dhe Parandalimi i Trafikimit të Qenieve Njerëzore</p>	<p>Kodi i ri Penal ka përmirësuar bazën ligjore për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Ky kod përforcoi ndëshkimin e krimeve penale veçanërisht në lidhje me trafikimin e fëmijëve. Strategjia mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2011-2014) është tashmë në implementim e sipër ndërsa Strategjia Kombëtare e re kundër Trafikimit të Fëmijëve plotëson kornizën e strategjive në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore. Tashmë ekziston përvojë katër vjeçare në këtë fushë.</p> <p>Një forcë e posaçme u krijua për tu ballafaquar me sfidat që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore, ndërsa forca për trafikimin e fëmijëve është në proces të konsolidimit. Në dy vitet e fundit Policia e Kosovës raportoi për rritje në efikasitetin e shkatërrimit të rrjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo erdhi si rezultat i ngritjes së kapaciteteve të Policisë së Kosovës për të luftuar këtë fenomen. Këto rezultate në masë të madhe janë rezultat i përpjekje</p>	<p>2.5</p>

	<p>institucionale për të arritur kërkesat teknike të BE-së për liberalizimin e vizave dhe proceset e tjera integruese. Sidoqoftë, përpjekje më të mëdha duhet të ndërmerren në parandalimin dhe luftimin e trafikimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve.</p>	
<p>Implementimi i Strategjisë kundër Drogës</p>	<p>Pengimi dhe luftimi i trafikimit të drogave përbën fushën në të cilën është bërë mjaft gjatë dy viteve të fundit. Legjislacioni dhe politikat përkatëse për luftimin e këtij fenomeni tashmë janë të miratuara. Strategjia Kombëtare kundër Drogës dhe Plani i Veprimit (2009–2012) kanë shërbyer si kornizë e politikave bazë për të luftuar trafikimin e drogës, ndërsa strategjia e re pritet të miratohet deri në fund të vitit 2012. Të gjeturat e hulumtimit kanë identifikuar përmirësime të konsiderueshme në qasjen dhe përpjekjet e institucioneve në luftën kundër drogës. Kjo rezultoi në dyfishimin e kapaciteteve institucionale në këtë fushë. Sipas zyrtarëve përkatës rezultatet në vendin tonë në luftën kundër kontrabandës të drogës janë nga më të lartat krahasuar me vendet e tjera në rajon. Sidoqoftë, shtrohet nevoja për konsistencë në zbatimin e politikave të anti-drogës për vitet e ardhshme.</p>	<p>3.5</p>
<p>Implementimi i Strategjisë për Anti-Korrupsion</p>	<p>Gjatë viteve të fundit, korniza ligjore për luftimin e korrupsionit është pothuajse e kompletuar. Tanimë Kodi i ri Penal ka përfshinë edhe kapitull specifik kundër veprave që kanë të bëjnë me korrupsionin e zyrtarëve shtetëror (gjë që mungonte në Kodin e Përkohshëm Penal). Ligji i vetëm i rëndësishëm i cili ende mungon është Ligji për Fuqitë e Zgjeruara dhe Konfiskimin e Pasurive të Fituara me Vepër Penale i cili ende është duke qarkulluar në sirtarët e Kuvendit të Kosovës. Në përgjithësi, legjislacioni i miratuar deri më tani në këtë fushë është në përputhje me Acquis të BE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Duke pasur parasysh se Strategjia Kundër Korrupsionit (2009–2011) tanimë ka skaduar, strategjia e re është në proces e sipër. Drafti i kësaj strategjie ende pa u miratuar ka hasur kritika nga Studimi Fizibilitetit i BE-së, andaj strategjia e ardhshme duhet të merr parasysh edhe rekomandimet e BE-së.</p> <p>Ndërkohë, është arritur një progres i kufizuar në implementimin e kornizës ligjore dhe të politikave. Arritjet më të dukshme janë identifikuar në krijimin e mekanizmave të reja. Përveç Agjencisë Anti-Korrupsion (e themeluar që nga viti 2006) u themeluan edhe dy mekanizma shtesë: Forca Anti-Korrupsion (e cila vepron nën përgjegjësinë e Kryeministrit) dhe Këshilli Kombëtar për Anti-Korrupsion (që vepron në kuadër të Presidentit të Kosovës). Në përgjithësi, legjislacioni i miratuar kohën e fundit ka shtuar përpjekjet institucionale në parandalimin e korrupsionit ndërsa rezultatet janë ende tejet të kufizuara sa i përket luftimit të rasteve konkrete të korrupsionit.</p>	<p>2</p>

<p align="center">Implementimi I Strategjisë kundër Terrorizmit</p>	<p>Lidhur me masat kundër terrorizmit, korniza ligjore dhe politike tashmë është e kompletuar dhe është në përputhje me Acquis e BE-së dhe standardet e tjera ndërkombëtare. Terrorizmi është identifikuar si një prej kërcënimeve serioze nga Strategjia e Sigurisë së Kosovës. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Terrorizmit 2009-2012 është i kompletuar. Nga pikëpamja institucionale, krijimi dhe konsolidimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale për të parandaluar dhe luftuar këtë fenomen. Nuk ka informacione të mëtejshëm që saktësojnë kapacitetet institucionale për implementimin e kornizës së politikave në këtë fushë.</p>	<p align="center">3</p>
--	---	--------------------------------

I. SFONDI I LIBERALIZIMIT TË VIZAVE

1.1. ZHVILLIMI I RËNDËSISË SË POLITIKAVE TË RENDIT PUBLIK DHE SIGURISË: PASQYRIMI I PROCESIT TË LIBERALIZIMIT TË VIZAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ideja e BE-së për liberalizimin e vizave për vendet e Ballkanin Perëndimor (BP) u prezantua në Samitin e Selanikut në qershor të vitit 2003. Këshilli i BE-së ka propozuar një listë të reformave te nevojshme për tu përmbushur nga të gjitha vendet në mënyrë që të përfitojnë nga një regjim pa viza. Me fjalë të tjera, Këshilli i BE-së bëri të qartë se progresi i vendeve të BP në procesin e liberalizimit të vizave do të jetë barrë e vet vullnetit dhe përkushtimit të këtyre vendeve për të zbatuar reforma substanciale në fushat e sundimit të ligjit dhe sigurisë. Vendeve të BP iu kërkua forcimi i kapaciteteve të tyre në luftimin e krimit të organizuar, korrupsionit, emigracionit të paligjshëm, si dhe të rrisin kapacitetet e tyre institucionale për të administruar dhe ushtruar kontrollin kufitar dhe prodhuar dokumente cilësore të identifikimit.¹

Në këtë drejtim, hapi i parë erdhi tre vjet më vonë, në vitin 2007 kur vendet e BP, me përjashtim të Kosovës, nënshkruan Marrëveshjen për Lehtësimin e Nxjerrjes së Vizave dhe Marrëveshjen për Ripranimin.²³ që kishte për qëllim lehtësimin e lirisë së lëvizjes së qytetarëve të BP-s gjatë kohës sa

¹ Agjenda e Selanikut, Këshilli Evropian, 15 Qershor 2003, http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accesion_process/how_does_a_country_join_the_eu/sap/thessaloniki_agenda_en.htm (qasja e fundit: 29 Qershor 2012)

² Kosova gjatë kësaj periudhe ishte në fazën përfundimtare të negociatave për statusin. Pas më pak se 4 muaj, në 17 shkurt 2008 Kosova shpalli pavarësinë e saj.

Dialogu i Strukturuar me BE-ishte në zhvillim e sipër.⁴ Ndërsa, Marrëveshja e Ripranimit synonte nxitjen e vendeve të BP për ta marrë përsipër ripranimin e qytetarëve të tyre që jetojnë në shtetet anëtare të BE-së pa pasur leje-qëndrim ligjor në këto vende.⁵

Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve fillestare dhe dialogu pasues kanë ndikuar në reformimin gjithëpërfshirëse të politikave të brendshme në gjithë rajonin e BP dhe në arritjen e progresit të rëndësishëm sa i përketë institucionalizimit të reformave në sundimin e ligjit dhe sigurisë. Andaj si rezultat i këtyre zhvillimeve pozitive në mesin e vitit 2008 Komisioni Evropian dorëzoi Udhërrëfyesin për Liberalizimin e Vizave në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë (B&H), Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Kosova u la jashtë kësaj iniciative si arsye e kompleksitetit politik që koincidoi me momentin e shpalljes së pavarësisë dhe implikimeve të tjera me të cilat ajo ishte duke u ballafaquar. Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Viza përfshinë kriteret të ndryshme teknike të cilat do të duhej të implementoheshin nga këto vende e të cilat ishin të kategorizuara në disa blloqe.

Blloku I përfshinte parakushtet për përmirësimin e Sigurisë së Dokumenteve; blloku II përcaktoi masat dhe kriteret për Menaxhimin e Integruar të Kufijve; blloku III i titulluar Rendi dhe Siguria Publike thekson nevojën për avancimin e përpjekjeve institucionale në luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar, korrupsionit, terrorizmit, nxitjen e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale dhe mbrojtja e të dhënave personale.⁶ Blloku i fundit merret me çështjen e të Drejtave Themelore dhe Lirinë e Lëvizjes të cilat janë të lidhura në mënyrë të tërthortë me bllokun III mbi Rendin dhe Sigurinë Publike.

Dialogu për viza në mes të Komisionit Evropian dhe vendet të BP është trajtuar në mënyrë të izoluar, ku secili vend veç e veç i është nënshtruar specifikacioneve individuale në këtë proces. Gjersa kriteret e përcaktuara në këtë proces kanë qenë pothuajse krejtësisht teknike, një gjë e tillë ka shtyrë këto vende në ndërmarrjen e reformave të mëdha në pjesët e synuara. Si rezultat, të gjitha vendet e BP (me përjashtim të Kosovës), përfunduan reformat e tyre në afatin e përcaktuar duke u shpërblyer me regjim të lirë të vizave. Fillimisht, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia ishin vlerësuar se kanë zbatuar më me sukses kriteret e parapara me "Udhërrëfyesit" duke ju dhënë liberalizmi i vizave në fund të vitit 2009, ndërsa Shqipërisë dhe B&H iu kërkua që të vazhdojnë zbatimin e reformave deri në fund të vitit 2010. Andaj, që atëherë Kosova mbeti vendi i vetëm në rajon pa ndonjë progres në procesin e liberalizimit të vizave.

³ Ibid, Shqipëria tashmë kishte nënshkruar Marrëveshjen e Ripranimit me BE në 7 nëntor 2005

⁴ Këshilli i Evropës, *Marrëveshjet me vendet e Ballkanit Perëndimor për lehtësimin e lëshimit të vizave*, 8 Nëntor 2007, http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/114578_en.htm

⁵ Këshilli i Evropës, *Marrëveshjet e Ripranimit me vendet e Ballkanit Perëndimor*, 8 Nëntor 2007 http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/western_balkans/114562_en.htm

⁶ Kontrolloni Blloku 3 i Liberalizimit të Vizave me Udhërrëfyesit, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia

1.2 SFIDAT POLITIKE TË KOSOVËS NE DIALOG TË STRUKTURUAR PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE

Pas shpalljes së pavarësisë, qëllimet kryesore të institucioneve të Kosovës janë integrimi i Kosovës në BE dhe NATO. Kjo ka bërë të jetë një çështje mjaft e komplikuar duke pasur parasyh mungesën e unitetit brenda BE-së lidhur me pavarësinë e Kosovës – ku 22 anëtarë të BE e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, ndërsa pesë anëtarë të tjerë si Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qipro ende refuzojnë njohjen e pavarësisë së Kosovës. Megjithatë, gjatë dekadës së fundit, BE-ja ka pasur disa zhvillime në lidhje me Kosovën, ku pavarësisht vonesave u iniciuan procese të mëtutjeshme.⁷ Në veçanti vlen të ceket fillimi i punës së Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në vitin 2008, i cili konsiderohet të jetë misioni më i madh i Sundimit të Ligjit në Politikën e Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrotjtjes së BE-së, duke bërë BE-në me përgjegjësi shtesë në sigurimin e të ardhmes së Kosovës në BE.

Njëra ndër arsyet kryesore në pengimin e Kosovës drejt procesit të liberalizimit të vizave është fakti që ajo ndan linjë kufitare të gjatë me Serbinë, e cila ka dështuar të marrë hapat e bashkëpunimit në fushat ku pozicioni i saj ndaj Kosovës do të rrezikohej.⁸ Në fakt, BE-ja ka iniciuar dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, duke filluar nga Marsi i 2010 që rezultoi në përcaktimin e regjimit të liberalizimit të vizave për Kosovën dhe kandidaturën e Serbisë për anëtarësim. Më saktësisht, gjate këtij dialogu rezultuan dy marrëveshje të rëndësishme në mes të Prishtinës dhe Beogradit nën patronatin e BE-së: Menaxhimi i Integruar të Kufirit e Bashkëpunimi Rajonal si dhe Marrëveshja për Lirinë e Lëvizjes.

Përveç arritjes në nënshkrimin të këtyre dy marrëveshjeve, ende nuk janë bërë hapa të rëndësishëm drejt zbatimit të tyre. Gjithashtu, marrëveshjet ishin zgjidhje politikisht të vështira dhe të papëlqyeshme nga të dy vendet. Prandaj, si rezultat i një kontributi konstruktiv të Kosovës dhënë në këtë dialog, Komisioni Evropian rekomandoi fillimin e dialogut të strukturuar për liberalizimin e vizave [19 Janar 2012]. Dialogu i strukturuar me Kosovën filloi në Maj 2012 dhe Udhërrëfyeni për Liberalizimin e Vizave është dorëzuar në Qershor të të njëjtit vit. Përveç kësaj, Komisioni i BE-së gjithashtu filloi Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizimit dhe Asocimit me Kosovën në Shkurt të vitit 2012.

⁷ Intervistë me Lutfi Haziri QKSS, Deputet i Kuvendit të Kosovës, Kryetar i Komisionit për Integritet Evropiane, 27 Qershor 2012

⁸ Ibid:

1.3 IMPLIKIMET E BRENDSHME TË DIALOGUT TË VIZAVE ME KOSOVËN (2009– 2012)

Gjersa për BE-në liberalizimi i vizave ka qenë në përgjithësi i përshkruar si një proces që përfshin reformat kryesisht teknike dhe vendim-marrëse, në rastin e Kosovës vërehen qartazi implikimet politike. Të ballafaquar me një bllokim politik për shkak të kundërshtimeve fillestare prej anëtarëve të BE –së që nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës dhe vështirësitë që rezultojnë nga një proces i komplikuar me Serbinë, Qeveria e Kosovës filloi ta vetë-hartoi Udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, në mënyrë që të përmbushë çfarëdo kushti që mund ti paraqitej.⁹ Hapi i parë në këtë drejtim ishte miratimi i njëanshëm i 'Planit të Veprimit për Implementimin e Udhërrëfyesit të Qeverisë së Kosovës për Liberalizimin e Vizave me Bashkimin Evropian " i cili në vetvete reflektonte një strukturë të ngjashme dhe qasje të negociuar nga BE-ja me vendet e tjera të BP.

Ky studim ka gjetur se fillimi i "Planit të Veprimit" rezultoi në miratimin e disa politikave qeveritare të rëndësishme në fushën e rendit publik dhe sigurisë – sigurinë e dokumenteve, menaxhimin e integruar të kufinjëve, si dhe migracionit dhe të drejtave themelore që lidhen me lirinë e lëvizjes. Me fjalë të tjera, ky hap shkaktoi një dinamizëm të dukshëm në përfundimin e gjeneratës së parë të ligjeve dhe strategjive kombëtare që mbulojnë këtë proces. Ndryshimet më të rëndësishme në dukje në këtë fazë ishin miratimi i Kodit të ri Penal, Ligji i ri për Menaxhimin e Integruar të Kufirit dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror (2008), Ligji mbi Azilin (2011), Ligji për të Huajt (2011), Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit (2010), Ligji mbi Pastrimin e Parave dhe Financimit të Terrorizmit (2010) dhe Ligji për Mbrojtjen e të dhënave Personale (2010).

Përveç ndryshimeve legjislativë, ky studim gjithashtu identifikoi një ritëm në rritje të përpjekjeve për miratimin e legjislacionit gjatë kësaj faze. Disa nga strategjitë e miratuara nga qeveria ishin Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Integruar Kufirit (2010–2012), Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit Kundër Krimit të Organizuar (2009–2011), Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit Kundër Trafikimit të Drogës (2009 –2011), Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2009–2011), Strategjia Kombëtare për Migracionin (2009–2012), Strategjia Kombëtare për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar (2009–2012) dhe Strategjia kundër Korrupsionit (2009–2012). Një numër i strategjive dhe veprimeve të tjera iu nënshtruan modifikimit bazuar në standardet evropiane.

Dokumenti zyrtar i BE-së “Udhërrëfyesi i Liberalizimit të vizave për Kosovën” i është dorëzuar Kosovës nga Komisioni Evropian katër vite me vonë, në Qershor 2012. Faza e procedimit ishte mjaft e vështirë dhe shumë sfiduese për shkak të problemeve brenda BE-së si dhe për shkak të situatës politike në Kosovë. Kapitujt në vijim do të vlerësojnë progresin e arritur nga institucionet e Kosovës në zbatimin e politikave të MIK, si dhe parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

⁹ QKSS Intervistë me Fatmir Xhelili, Ish-zëvendës Ministri i Punëve të Brendshme (2007-2010), aktualisht Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe gjithashtu anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, 14 Qershor 2012,

II. IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE TË RENDIT PUBLIK DHE SIGURISË

2.1. IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE TE MENAXHIMIT TË KUFIRIT NË KOSOVË

KORNIZA
LIGJORE Politika për Menaxhimin e Integruar të Kufinjëve (MIK) është e rregulluar me Ligjin për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror që hyri në fuqi në qershor të vitit 2008 si pjesë e paketës ligjore të paraqitur nga Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës. Edhe zyrtarët vendorë¹⁰ edhe ata ndërkombëtarë¹¹ kanë vlerësuar legjislacionin e miratuar në këtë fushë si shumë të avancuar dhe në përputhje me Acquis të BE-së.¹² Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë koordinim të qëndrueshëm dhe bashkëpunim ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente (vendore dhe ndërkombëtare) të

¹⁰ QKSS Intervistë me Kolonel Shaban Guda, Drejtorja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), Policia e Kosovës, 27 Gusht 2012

¹¹ QKSS Intervistë me Karin, Marmsoler, Këshilltar Politik - Sundimi i Ligjit, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, 29 Qershor 2012

¹² QKSS Intervistë me Kolonel Shaban Guda, Drejtorja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), Policia e Kosovës, 27 Gusht 2012

përfshira në sigurinë kufitare si dhe për lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave. Ligji do të mundësojë kushte për krijimin e një strukture të menaxhimit kufitar sa më efikas dhe efektiv duke mundësuar një kufi të hapur, mirëpo gjithmonë të kontrolluar e të sigurt.¹³

Sipas dispozitave të këtij ligji, bashkëpunimi në mes agjencive do të kryhet nga Policia Kufitare, Shërbimi Doganor, Shërbimi Fito-Sanitar dhe Veterinar (SFSV), si dhe nga të gjitha agjencitë e tjera relevante, siç përcaktohet në Strategjinë Kombëtare për Menaxhim të Integruar të Kufijve.¹⁴ Në fazën e parë katër vjeçare, pas miratimit të ligjit, Qeveria ka miratuar një numër të udhëzimeve administrative dhe strategjive për forcimin e kapaciteteve të implementimit. Këto hapa pasuese kanë mundësuar përfundimin e infrastrukturës ligjore në lidhje me menaxhimin e integruar të kufirit.

Në prill 2009, Qeveria miratoi "Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (2009-2012)". Kjo strategji është e bazuar në qasjen e BE-së në ndërtimin e MIK mbi tre shtylla themelore - bashkëpunimi brenda institucional, bashkëpunimi ndër-institucional si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.¹⁵ Qeveria krijoi një strukturë koordinuese nën udhëheqjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme që do të ketë rol në vendim-marrje dhe autoritet mbikëqyrës. Struktura duhej të përfshinte përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave (MEF), Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTPT), Ministria e Shëndetësisë (MSH), dhe Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ). Faza e dytë e menaxhimit përfshin Bordin Ekzekutiv i cili përbëhet nga Koordinatorët Kombëtar për MIK, Ndihmësdrejtori i Përgjithshëm për Policinë Kufitare, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave të Kosovës, Shefi ekzekutiv i Agjencisë së Veterinarisë dhe të Ushqimit, ish Agjencia për Koordinimin dhe Zhvillimin dhe Integrimin Evropian, si dhe përfaqësues të tjerë që konsiderohen të nevojshëm.¹⁶

Gjithë paketa e strategjive dhe planeve të veprimit ka rezultuar nga vendimi i qeverisë për të nisur procesin e përmbushjes së njëanshme të kushteve për liberalizimin e vizave në vitin 2008 ku ka mbuluar një periudhë prej tre vjetësh. Procesi i amendamentimit të strategjisë ekzistuese ka përfunduar, ku një version i modifikuar do të miratohet deri në fund të vitit 2012.¹⁷ Sidoqoftë, nuk pritet të ketë ndryshime substanciale. Përveç strategjisë së MIK, strategjitë e tjera të lidhura me këtë fushë janë miratuar në fushën e krimit të organizuar, kundër-terrorizmit dhe në çështjet e migracionit. Vlerësimi i implementimit të strategjive në krimin e organizuar dhe kundër-terrorizmin do të diskutohen në kapitujt në vijim, ndërsa politikat e migrimit nuk janë vlerësuar në këtë studim.

**IMPLEMENTIMI
BRENDA
INSTITUCIONAL**

Hapat e parë për implementimin e kësaj strategjie përfshijnë themelimin e një ekipi koordinues të kryesuar nga Zëvendësministri i Punëve të Brendshme. Agjencitë e MIK në bashkëpunim me Qeverinë themeluan Qendrën Kombëtare për Kontrollin e Kufirit, në mënyrë që të rritet efikasiteti dhe koordinimi. Kjo qendër

¹³ Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Neni 1, Kuvendi i Kosovës, 15 Qershor 2008,

¹⁴ Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufirit Shtetëror, Neni 1, Kuvendi i Kosovës, 15 Qershor 2008, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L065_en.pdf

¹⁵ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (1999-2012), Qeveria e Kosovës, Prill 2012, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_Anglisht_FINAL_National_strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2009.pdf

¹⁶ Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (1999-2012), Qeveria e Kosovës, Prill 2012, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_Anglisht_FINAL_National_strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2009.pdf

¹⁷ QKSS Intervistë me Kolonel Shaban Guda, Drejtoria për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), Policia e Kosovës, 27 Gusht 2012

është e përbërë nga Policia, Dogana, si dhe Shërbimi Fito-Sanitar dhe Veterinar, e cila synon të lehtësojë shkëmbimin e informacionit mbi çështjet lidhur me MIK. Mekanizmi i themeluar rishtazi ndihmon dukshëm në përmirësimin e koordinimit në mes organeve përkatëse. Këto organet dhe shërbime tani organizojnë patrullime të përbashkëta, pika kontrolli, pajisje të këmbimit dhe informacionit, si dhe organizojnë mbledhje të përbashkëta në formë të trajnimit.¹⁸ Kjo formë është vlerësuar në përgjithësi të ketë prodhuar rezultate dhe përmirësime në kalimet kufitare.¹⁹

Një nga dobësitë kryesore e këtij bashkëpunimi ende mbetet mungesa e mjaftueshme e bazës së përbashkët të të dhënave.²⁰ Megjithatë, agjencitë kanë iniciuar një nismë të re për zhvillimin e një sistemi të përbashkët të shkëmbimit të informacionit si pjesë e ekipit të MIK.²¹ Kjo ngërthen implikime të konsiderueshme buxhetore dhe mund të marrë kohë për të përfunduar. Zyrtarët e Policisë së Kosovës theksuan rëndësinë e përfundimit të këtij hapi edhe pse zhvillimi i një baze të përbashkët të të dhënave nuk është një kusht i BE-së për procesin e liberalizimit të vizave.²²

Në këtë pikë, ndër problemet tjera kryesore është edhe niveli i kufizuar i kontrollit të brendshëm dhe mbikëqyrjes. Kjo dëshmohet nga mungesa e një procesi të kontrollit sistematik në disa pika kufitare.²³ Edhe pse zyrtarët e Policisë së Kosovës kanë pranuar dobësitë në këtë fushë, ata theksuan se kjo ndodh vetëm gjatë periudhave të pushimeve, kur një kombinim i fluksit të turistëve të jashtë dhe diasporës kosovare ngarkon kapacitetet ekzistuese. Sipas policisë, numri i personave që kalojnë kufirin me Shqipërinë varion midis 30,000-40,000 mijë, dhe kjo ka implikime në kapacitetet e policisë në dispozicion për të trajtuar këtë numër. Prandaj, kjo vënë në dyshim aftësinë për të ushtruar nivelet e duhura të kontrollit. Gjersa zyrtarët janë në njohuri për këtë sfidë, ata gjithashtu deklaruan se ka përjashtim në makinat e pasagjerëve dhe njerëzit, ndërsa vetëm transporti i mallrave i nënshtrohet një inspektimi më të detajizuar.

Mungesa e kapaciteteve dhe përvojave në kontrollin e brendshëm lë hapësirë të konsiderueshme për ndodhjen e praktikave korruptive. Përderisa kjo është e kuptueshme për një inspektorat relativisht të ri, shtrohet nevoja për të rritur kapacitetet mbikëqyrëse në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet e mundshme të autoritetit në kalimet kufitare²⁴

MIK
BASHKËPUNIMI
NDER-KUFITAR

Përveç komponentës së bashkëpunimit të brendshëm, Qeveria ka bërë progres të rëndësishëm në bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërkombëtar. Shembujt më të dukshëm janë zbatimi i MIK me Shqipërinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Politika e re dëshmoi efikasitetin më të madh sidomos në vendkalimet kufitare më Shqipërinë. Kjo ka çuar në një menaxhim më të mirë dhe më të shpejtë të fluksit të mallrave dhe të njerëzve që arrijnë në numra shumë të lartë sidomos gjatë sezonit të verës. Zyrtarët nga të dyja vendet

¹⁸ Ibid:

¹⁹ Ibid:

²⁰ Ibid

²¹ Ibid:

²² Ibid

²³ QKSS Intervistë me Karin, Marmsoler, Këshilltar Politik - Sundimi i Ligjit, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, 29 Qershor 2012

²⁴ Ibid.

kanë vendosur patrulla të përbashkëta policore kufitare, si dhe një pikë-kalimi kufitar të vetëm. Procedurat e thjeshtësuara për shkak të komunikimit gjuhësor kanë ulur edhe sasinë e kohën e pritjes në kufi.²⁵

Edhe pse jo në nivelin e njëjtë si me Shqipërinë, MIK ka dëshmuar efikasitet edhe në rastin e Maqedonisë. Mirëpo, asnjë patrullë e përbashkët dhe pikë e vetme e kalimit nuk është implementuar. Ka pasur bisedime ndërmjet zyrtarëve të Kosovës dhe atyre Maqedonas për çështjen e dokumenteve të kërkuara për të kaluar në territorin e njëri-tjerit. Megjithatë, hulumtimet kanë identifikuar takime të rregullta në mes të ekipeve të koordinimit MIK, duke zhvilluar edhe hapa konkrete që lidhen me këto çështje.

Sa i përket Malit të Zi, hulumtimi ynë ka identifikuar një bashkëpunim të shëndoshë në mes të këtyre dy shteteve, duke pasur një bashkëpunim të ngushtë në mes të ekipeve përkatëse të koordinimit të MIK. Gjithashtu, ka pasur edhe patrullime policore të përbashkëta në të dy pjesët e kufirit sidomos pas dorëzimit të përgjegjësive nga KFOR-i tek Policia e Kosovës. Megjithatë, një thellim i bashkëpunimit duket pjesërisht për tu kushtëzuar me zgjidhjen e çështjes së demarkacionit të kufirit.²⁶ Duke pasur një kufi të përcaktuar qartë me Kosovën, kjo çështje nuk ka qenë një kusht për Malin e Zi gjatë dialogut për liberalizimin e vizave dhe zyrtarët qeveritarë nuk presin që kjo të ngadalsojë shanset për një përfundim të shpejtë të procesit.

Zbatimi i MIK me Serbinë mbetet një çështje politikisht e ndjeshme dhe e komplikuar. Kjo është edhe një ndër çështjet më delikate duke marrë parasysh mosnjohjen e autoritetit të Policisë së Kosovës në pikat e kalimit verior të Kosovës (Bërnjak dhe Jarina). Zbatimi i MIK në vendkalimet tjera (Merdarë dhe Dheu i Bardhë) është nën kontrollin e plotë të autoriteteve të Kosovës dhe si rrjedhojë MIK këtu duket të jetë më pak i komplikuar. Kontrolli dhe shtrirja e sundimit të ligjit në pjesën veriore të dominuar nga komuniteti etnik serb ka qenë shumë e dobët. Përpyekjet e Qeverisë për të marrë kontrollin e plotë kanë rezultuar në reagime serioze duke çuar në djegien e pikave kufitare nga ekstremistët.²⁷ Kjo situatë e tensionuar dhe e brishtë ka rezultuar në një terren profitabil për kontrabandë. Të dy kalimet kufitare janë nën kontroll të EULEX-it ku roli i Policisë së Kosovës është pothuajse joekzistues.

Serbia refuzon të njohë pavarësinë e Kosovës dhe nuk ka pranuar ekzistencën e kufirit. Përkundrazi, kalimet kufitare i konsideron si vija administrative. Megjithatë, kjo sfidë politike ka ndikuar në masë të madhe në procesin e implementimit të MIK. Një formë e të kuptuarit është arritur gjatë dialogut Prishtinë-Beograd i ndërmjetësuar nga BE-ja. Në vitin 2012 janë arritur marrëveshjet për lirinë e lëvizjes, si dhe dokumentet dhe targat e automjeteve në kuadër të MIK, mirëpo implementimi i tyre ka qenë i ngadalshëm pjesërisht për shkak të zhvillimeve të brendshme politike dhe zgjedhjet në Serbi.²⁸

Gjithashtu, Kosova ka bërë përparim të konsiderueshëm në vendosjen e bashkëpunimit me vendet tjera të rajonit. Megjithatë duke pasur parasysh se bashkëpunimi më i gjerë rajonal dhe ndërkombëtar darrihet me marrëveshjeve të bashkëpunimit në fusha të ndryshme (të tilla si: migracionit, asimilimi, policia kriminale,

²⁵ QKSS Intervistë me Behar Selimi, Ish-drejtor i Policisë së Kosovës, Deputet i Kuvendit të Kosovës, 11 Qershor 2012

²⁶ Përcaktimi i kufijve në Ballkanin Perëndimor, Perspektiva e Popullit, Saferworld, Tetor 2011, <http://www.saferworld.org.uk/downloads/pubdocs/Drawing%20boundaries%20in%20the%20Western%20Balkans.pdf>

²⁷ MBROJTËSI, Volume IV- Nr. 2, Policia e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Policisë së Kosovës, Maj 2008, <http://www.kosovopolice.com/repository/docs/internet.pdf>

²⁸ Transkripta e mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të OKB -Gjashtëdhjetë e shtatë vjeçare, Nju Jork 6822, e Martë, 21 Gusht 2012, 10:00. <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20S%20PV%206822.pdf>

drejtësisë, si dhe marrëveshjet e tjera ekonomike), të cilat janë të lidhura edhe me politikat kufitare, kjo mund të jetë një temë tjetër e një hulumtimi të caktuar në të ardhmen dhe se nuk është analizuar në këtë studim.²⁹

2.2. IMPLEMENTIMI I POLITIKAVE QEVERTARE NË PARANDALIMIN E KRIMIT TE ORGANIZUAR, KORRUPSIONIT, DHE TERRORIZMIT

Fenomeni i krimit të organizuar dhe korrupsionit është përhapur në Ballkanin Perëndimor për shkak të konflikteve të ndryshme dhe dobësive të institucioneve shtetërore. Ky studim ka gjetur se Kosova ka shënuar progres në drejtim të forcimit të kapaciteteve institucionale për të parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar dhe korrupsionin. Gjersa, terrorizmi nuk është perceptuar të jetë një kërcënim i madh për Kosovën, Qeveria ka ndërmarrë disa hapa të cilët synojnë të garantojnë sigurinë edhe në këtë fushë. Ky kapitull analizon këto fenomene dhe progresin e bërë në Kosovë në tri fushat në vijim: (a) parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, (b) parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe (c) parandalimin dhe luftimin e terrorizmit.

A. PARANDALIMI DHE LUFTIMI KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

KORNIZA LIGJORE

Në vitet e fundit, parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar në Kosovë është shëndërruar në një çështje e cila ka tërhequr vëmendjen më të madhe institucionale dhe publike. Gjatë katër viteve të fundit, institucionet e Kosovës kanë miratuar një pjesë të madhe të legjislacionit ku ndër të tjera përfshihet: Ligji për Prokurorinë Speciale, Menaxhimin e Integruar të Kufirit; Ligji kundër korrupsionit; Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve; Ligji për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, si dhe Kodi i ri Penal (i cili do të hyjë në fuqi më 1 Janar 2013). Në ndërkohë, vërehet se ka pasur ngecje në miratimin e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit të Organizuar. Ky ligj është pritur që të shërbente si një instrument i rëndësishëm ligjor për të ndihmuar përpjekjet e luftimit dhe parandalimit të krimit të organizuar. Gjithashtu, as ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore nuk është miratuar ende.³⁰ Megjithatë, ligjet në fjalë kanë qenë të përfshira në agjendën legjislative dhe është menduar të miratohet së shpejti.³¹ Në mungesë të këtyre ligjeve, luftimi dhe parandalimi i krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore ligjërisht vazhdon të jetë i bazuar vetëm në kodin penal dhe kodin e procedurës penale. Prandaj, në periudhën e ardhshme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Kuvendi i Kosovës duhet të punojnë më intensivisht në plotësimin e kuadrit ligjor në këtë fushë.

²⁹ QKSS Intervistë me Kolonel Shaban Guda, Drejtoria për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), Policia e Kosovës, 27 Gusht 2012

³⁰ Interviste me Arben Pacarrizi, Policia e Kosovës, Departamenti kundër Trafikimit të Drogës, 25 Qershor 2012

³¹ Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, Botuar në faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës

Zyrtarët e Kosovës kanë pohuar se legjislacioni lidhur me luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar në Kosovë është miratuar në bazë të standardeve ndërkombëtare demokratike dhe është në përputhje me Acquis Communitare të BE-së. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se institucionet e Kosovës dhe në veçanti Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Integritimit Evropian dhe Komisioni për Integritime Evropiane në Kuvendin e Kosovës kanë qenë shumë aktiv në harmonizimin e legjislacionit me Acquis Communitare të BE-së. Megjithatë, në raste të caktuar këto përpjekje kanë hasur në ngecje për tu materializuar me sukses për shkak të mungesës së ekspertizës dhe kapaciteteve institucionale në Kuvendin e Kosovës. Madje, veprime konkrete për të adresuar këto mangësi janë ndërmarrë nga ana e vet sponsorëve kryesor ndërkombëtarë të këtyre ligjeve, ku në shumicën e rasteve është edhe vet Bashkimi Evropian.³²

STRATEGJITË

Përveç ligjeve, Qeveria ka ndërmarrë hapa të tjerë për të zhvilluar politikat dhe strategjitë pasuese si: Strategjia për Krimin e Organizuar, Strategjia mbi Trafikimin e Qenieve Njerëzore dhe Strategjia për Trafikimin e Drogës. Secila prej këtyre strategjive të nevojshme kërkojnë krijimin e një task-force për implementimin e objektivave të saj. Gjersa vendimi për të krijuar forca të ndryshme reflekton përkushtim të vazhdueshëm institucional, në anën tjetër, duhet theksuar se këto kanë shkaktuar mjaft mos-kordinim dhe implikime të panevojshme buxhetore.³³ Në fakt, fillimisht kishte pasur thirrje të ndryshme në drejtim të Qeverisë që të hartohet një super-strategji ku do përfshiheshin të gjitha strategjitë e tjera që synojnë të forcojnë përpjekjet institucionale në luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar.³⁴

Megjithatë, duke pasur parasysh që progresi në integrimin në BE dhe liberalizimin e vizave mbetet një nga prioritetet më kryesore të Qeverisë së Kosovës dhe parandalimi dhe luftimi i fenomenit të krimit të organizuar është një pjesë e rëndësishme e saj, Qeveria vendosi të hartojë strategji të veçanta për secilin komponent të krimit të organizuar, madje duke rrezikuar që të këtë implikime shtesë sa i përket kostos buxhetore. Gjersa gjatë kësaj periudhe ka pasur progres në implementimin e legjislacionit dhe strategjive në kuadër të kësaj fushe, edhe më tutje praktikat institucionale duhet të avancohen dhe se ende vërehen mangësi të shumta. Me specifikisht, krijimi i task forcave brenda institucioneve të policisë në shumë raste krijoi një mungesë të komunikimit në mes të task-forcave të fushave të ndryshme si p.sh. komunikimi në mes të task-forcave për luftimin e trafikimit të drogave dhe asaj për trafikimin e qenieve njerëzore dhe të tjera. Madje, në shumë raste gjetjet tregojnë se ka mosgatishmëri në mes të task-forcave për të shkëmbyer informacione dhe për të punuar së bashku në fusha të ndërlidhura, gjë që ka krijuar një ndjenë mosbesimi mes këtyre task-forcave.³⁵

Strategjia kryesore mbi bazën e të cilës bazohet luftimi i krimit të organizuar në Kosovë është Strategjia Kombëtare dhe Plani të Veprimit të Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar (2009–2011). Kjo strategji përkufizon luftimin dhe parandalimin e krimit të organizuar duke u bazuar në parimet ndërkombëtare që kërkojnë ndjekjen dhe ndëshkimin e aktiviteteve si në vijim: 1) trafikimin e qenieve

³² QKSS Intervistë me Lutfi Hazirin, Deputet i Kuvendit të Kosovës, kryetar i Komisionit për Integritime Evropiane, 27 qershor 2012. Vlen të përmendet veçanërisht mbështetja e dhënë nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), por edhe nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare të tilla si Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, Lëvizja FOL (Lëvizja Fol), Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), si dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

³³ QKSS Intervistë me Rifat Marmallaku, Ish-kolonel i Policisë së Kosovës, Analist i pavarur i politikave të sigurisë, 13 Qershor 2012

³⁴ QKSS Intervistë me Rifat Marmallaku, Ish-kolonel i Policisë së Kosovës, Analist i pavarur i politikave të sigurisë, 13 Qershor 2012

³⁵ QKSS, Intervistë me Peter Achtelik, Njësia për Krim të Organizuar, Policia EULEX-i, 13 Korrik 2012,

njerëzore, veçanërisht gratë dhe fëmijët; 2) kontrabandën e emigrantëve dhe 3) prodhimitarinë e kundërligjshme dhe trafikimit të armëve, pjesëve të armës dhe municionit.³⁶ Përveç Strategjisë së Krimin të Organizuar, ka edhe strategji të tjera të miratuara të cilat ndër të tjera kanë si synim edhe parandalimin dhe luftimin e krimin të organizuar, të tilla si: Strategjia e MIK, "Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore"³⁷ dhe gjithashtu "Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër trafikimit të Drogës", të cilat kanë për qëllim rregullimin e fushave specifike që lidhen me parandalimin dhe luftimin e krimin të organizuar.

Shumica e këtyre strategjive janë miratuar gjatë periudhës 2008–2009 me vlefshmëri 3 vjeçare, ku disa prej tyre tashme kanë skaduar ose apo do të skadojnë deri në fund të vitit 2012. Deri në Tetor të vitit 2012, vetëm strategjia kundër trafikimit njerëzor është plotësuar me Strategjinë e re Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në (2011–2014).³⁸ Zyrtarët thonë se vonesat mbi modifikimin e strategjive ekzistuese janë si rezultat i pritjeve të Qeverisë për tu pajisur fillimisht me Udhërrëfyesin për Kosovën që më pastaj të konsiderohet përfshirja e udhëzimeve të dala nga ky Udhërrëfyes në draftet e ripërtirra të këtyre strategjive. Në këtë drejtim, strategjitë e modifikuara që priten së shpejti të jenë në fuqi priten të jenë më të avancuara se draftet e përparshme duke pasqyruar në mënyrë më adekuate kërkesat e parapara me udhërrëfyesit për liberalizim të vizave, si dhe ato të parapara ne proceset e integrimin në Evropine.

**STRATEGJIA
KOMBËTARE
KUNDËR
TRAFIKIMIT TE
QENIEVE
NJERËZORE**

Kur flitet për trafikimin e qenieve njerëzore, kjo është vepër e ndëshkueshme sipas Kodit Penal.³⁹ Në anën tjetër, megjithëse mendohej se Kosova duhet të ketë një ligj të veçantë për luftimin dhe parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore kjo nuk ndodhi.⁴⁰ Këto vonesa janë shkaktuar kryesisht për shkak se Kodi i ri Penal i cili ishte menduar t'i paraprijë këtij ligji ende ishte në procesin e miratimit. Në përgjithësi, Kodi Penal i vjetër ndëshkon shumicën e situatave të cilat kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore, megjithatë kishte edhe mangësi dhe paqartësi në kuadër të dispozitave të tij të cilat kishin nevojë për rishqyrtim. Kodi i ri Penal, ashtu sikurse është pritur, ka përfshirë dispozita shtesë që lidhen me veprat penale të trafikimit të njeriut, duke përfshirë kështu lypjen e detyrueshme, vjedhjet e vogla dhe shitjet e drogës si vepra penale.⁴¹

Duke pasur parasysh që trafikimi i qenieve njerëzore është konsideruar si shumë shqetësues, në kuadër të përpjekjeve institucionale për të luftuar këtë fenomen, Qeveria kishte miratuar 'Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2008–2011).'⁴² Kjo strategji është

³⁶ Faqja 7 e 'Strategjisë Kombëtare dhe Planin të Veprimit të Republikës së Kosovës kundër Krimin të Organizuar' (2009-2011), Qeveria e Kosovës, Qershor 2009

³⁷ Shiko strategjitë përkatëse "Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2008-2011) dhe (2011-2014)", Ministria e Punëve të Brendshme, 2008

³⁸ QKSS, Intervistë me Arben Pacarrizi, Policia e Kosovës, Departamenti Kundër Trafikut të drogës, 25 Korrik, 2012

³⁹ Neni 139: Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Kodi i Përkohshëm Penal, Kuvendi i Kosovës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, http://www.unmikonline.org/regulations/2003/RE2003_25_criminal_code.pdf

⁴⁰ QKSS Intervistë me Arben Pacarrizi, Policia e Kosovës, Departamenti Kundër Trafikut të Drogës 25 Korrik 2012

⁴¹ Ibid:

⁴² Shiko strategjitë përkatëse "Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për të Luftuar Trafikimin e Qenieve Njerëzore (2008-2011) dhe (2011-2014)", Ministria e Punëve të Brendshme, 2008

ripërtrirë me një strategji të re duke e plotësuar atë me dispozitat e reja të Kodit Penal.⁴³ Kështu, strategjia e re hap rrugën për miratimin e një strategjie të re për trafikimin e fëmijëve.⁴⁴ Si rrjedhojë, u miratua Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve duke krijuar një shtyllë të re për anti-trafikim.⁴⁵

Gjetjet e këtij hulumtimi aludojnë në një progres në ngritjen e koordinimit dhe rritjen e përpjekjeve institucionale dhe kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.⁴⁶ Në kuadër të këtyrë përpjekjeve fillimisht ishte krijimi i Zyrës së Koordinimit Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Kjo zyrë e cila tashmë është e konsoliduar organizon takime të ndryshme dhe raporton rregullisht tek grupi ndër-ministor i cili është i përfshirë në zbatimin e strategjisë dhe planit të veprimit. Gjithashtu, *Seksioni për Edukimin dhe Mbrojtjen e Viktimave* ishte në funksion dhe i dizajnuar për të vepruar në kuadër të Drejtorisë së PK-së për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore.⁴⁷ Ndërkohë, ajo cka vërehet më sfiduese ishte koordinimi i përpjekjeve midis task forcave të ndryshme punuese për zbatimin e strategjisë anti-trafikimit. Hulumtimi ynë ka vërejtur disa raste kur departamentet e ndryshme brenda Policisë kanë hezitur të shkëmbejnë informacione të nevojshme për task-forcën tjetër.⁴⁸ Këto praktika joadekuate brenda Policisë në shumë raste janë si pasojë e mungesës së përvojës në përvetësimin e qasjeve bashkëpunuese në parandalimin e krimit, duke alarmuar nevojën për të adresuar këto çështje sa më parë.

Sipas statistikave të siguruar nga Policia, gjatë tre viteve të kaluara mesatarisht nga 52-69 raste janë hetuar sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Studimi ka vërejtur një rritje të efektivitetit nga ana e Policisë për të hetuar dhe ndjekur penalisht këto raste. Numri i personave të akuzuar për trafikimin njerëzor shkoi nga 52 persona në vitin 2011 në rreth 183 në vitin 2012.⁴⁹ Megjithatë, këto shifra përfaqësojnë vetëm rastet e trafikimit të grave dhe nuk japin ndonjë referencë ndaj rasteve të tjera të mundshme të trafikimit, veçanërisht trafikimit të fëmijëve. Kodi i ri Penal i cili pritet të hyjë në fuqi që nga viti 2013 tashmë ka sanksionuar pikërisht disa vepra të cilat ndërlidhen me trafikimin dhe shfrytëzimin e kundërligjshëm të fëmijëve gjë që pritet të shërbej si instrument i rëndësishëm ligjor për të trajtuar këtë fenomen, i cili kohëve të fundit është përhapur mjaft në formën 'lypjes së detyruar'.

Sipas statistikave Policore, vërehet se ka pasur një rënie në numrin e viktimave të trafikimit me origjinë nga vendet e huaja, duke u zëvendësuar me një rritje të vogël të numrit të viktimave të brendshme të trafikimit.⁵⁰ Megjithëse është mjaft e vështirë që të gjurmohet ndonjë progres real në drejtim të zvogëlimit të numrit të viktimave. Statistikat megjithatë tregojnë për rritje të efikasitetit nga ana e policisë kufitare për të parandaluar futjen e viktimave të trafikimit në territorin e Kosovës.

⁴³ QKSS Intervistë me Arben Pacarrizi, Policia e Kosovës, Departamenti Kundër Trafikut të drogës, 25 Korrik, 2012

⁴⁴ Ibid:

⁴⁵ Ibid:

⁴⁶ 2012 Raport mbi Trafikimin e Personave - Kosovë, Shtetet e Bashkuara - Departamenti i Shtetit, 19 Qershor 2012

<http://www.unhcr.org/refworld/country,,USDOS,,SRB,,4fe30cb832,0.html>

⁴⁷ QKSS Intervistë me Arben Pacarrizi, Policia e Kosovës, Departamenti Kundër Trafikut të Drogës 25 Korrik 2012

⁴⁸ QKSS, Intervistë me Peter Achtelik, Njësia për Krim të Organizuar, EULEX-i Policia, 13 Korrik 2012

⁴⁹ Shih Tabelat 1 e ofruara më poshtë nga Drejtoria e PK-së për Hetimin Trafikimit të Qenieve Njerëzore

⁵⁰ Shih tabelën 2 më poshtë dhënë nga Drejtoria e PK-së për Hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore

Bashkëpunimi me gjyqësorin mbetet ende sfidues në lidhje me trafikimin e drogës, megjithatë gjatë viteve të fundit edhe ky sektor ka pasur përmirësim të dukshme falë reformave që janë duke ndodhur në këtë sektor.

Tabela 1: Numri i rasteve të hetuara nga Policia e Kosovës gjatë 4 viteve të fundit:⁵¹

Rastet/Hetimet	2009	2010	2011	2012 Janar – Qershor
Rastet e Hapura të Hetimit	69	57	66	64
Rastet e dorëzuara në Prokurori/Gjykatë	55	50	65	59
Rastet – informatat nën hetime	14	7	47	49
Rastet në bazë të llojeve të Kallëzimeve Penale	2009	2010	2011	2012
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	32	31	28	21
Mundësim i Prostitucionit	4	8	11	18
Prostitucioni	11	14	17	22
Skllavëria e imponuar/Punë e padëshiruar	/	/	/	/
Akuza tjera	22	4	10	3
Totali i Rasteve	69	57	66	64
Kontrolli i Lokaleve te Dyshuara	2009	2010	2011	2012 Janar-Qershor
Numri i kontrollimeve	521	709	342	197
Mbyllja e Lokaleve te Dyshuara	70	88	37	19
Arrestimi bazuar ne akuzat penale/4 vitet e fundit	2009	2010	2011	2012 Janar-Qershor
Trafikimi i Qenieve Njerëzore	34	76	91	74
Mundësim i Prostitucionit	3	13	39	26
Prostitucioni	9	27	50	31
Akuza te tjera	6	5	3	4
Totali i Arrestimeve	52	121	183	135

⁵¹ Tabela dhënë nga Policia e Kosovës, 25 korrik 2012

Tabela 2: Statistikat në lidhje me origjinën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore në katër vitet e fundit⁵²

Origjina e viktimave te identifikuar nga trafikimi	2009	2010	2011	2012 Janar/Qershor
Kosovë	16	28	35	26
Shqipëri	3	7	1	1
Moldavi	8	1	/	2
Bullgari	1	/	/	/
Serbi	1	2	3	/
Poloni	/	1	/	/
Sllovaki	/	/	/	1
Totali i viktimave te identifikuar	29	39	39	30
Totali i viktimave te trafikimit të të miturve	7	16	7	8

**STRATEGJIA
KOMBËTARE E
ANTI-DROGËS**

Një çështje me shqetësim të madh për Kosovën gjatë viteve të fundit ishte edhe trafikimi i drogës. Raportet e ndryshme gjatë viteve të fundit kanë renditur Kosovën si vend tranzit për trafikimin e drogës, duke ndikuar negativisht në imazhin e saj. Në mënyrë që të përmirësohet një gjendje e tillë, në vitin 2009 qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare dhe Planin të Veprimit të Anti-drogës (2009–2012).⁵³ Kjo strategji ka shërbyer si platformë kryesore institucionale për të parandaluar dhe luftuar trafikimin e drogës në Kosovë. Strategjia promovon kujdesin dhe rehabilitimin e përdoruesve të drogës, parandalimin e përdorimit të drogës dhe eksperimentimit me drogë; ndërhyrjet e hershme për të reduktuar përdorimin e drogave të ndërlidhura me shëndetin dhe pasojat sociale, dhe qasjet në trajtim, rehabilitim dhe ri-integrim social të cilat tash më janë adaptuar në përputhshmëri pothuajse të plotë me standardet ndërkombëtare.⁵⁴

Sipas zyrtarëve të angazhuar në implementimin e kësaj strategjie, procesi i implementimit rezulton të jetë në nivel relativisht të kënaqshëm. Madje, bazuar në vlerësimet e bëra në prill 2012, u konstatua se rreth 70% e objektivave të identifikuar nga kjo strategji ishin realizuar me sukses.⁵⁵ Nga 57 aktivitetet e përgjithshme, 19 ishin për të reduktuar kërkesën për drogë, 23 ishin për të zvogëluar numrin e ofruesve të drogës, ndërsa 14 ishin kundër bashkëpunësorëve dhe koordinimin e tyre. Zona në të cilën Task-forca ka treguar progresin më të lartë ishte reduktimi i ofruesve të drogës me 89% të objektivave të realizuara,

⁵² Tabela dhënë nga Policia e Kosovës, 25 korrik 2012

⁵³ Shih Strategjinë Kombëtare Anti-Drogë dhe Planin e Veprimit (2009-2012), Ministria e Punëve të Brendshme, Qershor 2009, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia_16_06_09_finale_kombetare_ENG.pdf

⁵⁴ Shih Strategjinë Kombëtare Anti-Drogë dhe Planin e Veprimit (2009-2012), Ministria e Punëve të Brendshme, Qershor 2009 http://www.mpb-ks.org/repository/docs/strategjia_16_06_09_finale_kombetare_ENG.pdf

⁵⁵ QKSS Intervistë me kapiten Bahri Shala, Policia e Kosovës, Departamenti Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 25 korrik 2012

ndërsa progresi më i ulët është arritur në zvogëlimin e kërkesës për drogë me vetëm 39% të objektivave të realizuara.⁵⁶

Sipas zyrtarëve të policisë nga Shtator 2011, kapacitetet e Drejtorisë për Hetimin e Trafikimit të Drogës të PK-së u dyfishuan.⁵⁷ Kohët e fundit PK ka arrestuar pjesëtarë të ndryshëm të grupeve kriminale dhe ka konfiskuar një sasi të madhe të drogës. Më saktësisht, sipas zyrtarëve të Policinë e Kosovës në periudhën Janar 2009 – Korrik 2012 ka reflektuar rritje të mëdha në fillimin e hetimeve nga Policia kundër trafikimit të substancave narkotike, që shkonin në rreth 20% në 25% për çdo vit vijues.⁵⁸ Policia e Kosovës ka vazhduar të ofrojë dëshmi konkrete në kapjen e sasive të mëdha të drogës. Sipas këtyre dëshmime, shumica e sasisë së drogës së kapur në Kosovë e ka origjinën nga jashtë dhe se vend-destinacionet finale (sidomos për kanabis dhe heroina) kishin qenë kryesisht shtetet anëtare të BE-së, të cilat pothuajse kishin ripohuar dyshimet e mëhershme se deri në kohët e fundit Kosova ishte përdorur në masë të madhe si vend transit.⁵⁹

Megjithatë, zyrtarët thonë se Kosova tashmë nuk mund të cilësohet më si vend transit për trafikimin e drogës. Deklaratat e zyrtarëve të Policisë së Kosovës mandej theksojnë se Kosova është bërë vendi më efikas në rajon kur bëhet fjalë për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të drogës⁶⁰, ndonëse nuk janë në gjendje të sigurojnë fakte adekuate për të matur progresin në vendet e tjera të rajonit për shkak të mosposedimit të databazave të përbashkëta. Sidoqoftë, treguesit e rëndësishëm të cilët aludojnë në zvogëlim të sasisë së drogës që qarkullon në Kosovë janë të bazuar nga disa faktor tjerë matës që tregojnë se kohët e fundit ka pasur shumë raste kur janë kapur tregtarë apo kultivues të vogël të drogës.⁶¹ Po ashtu, sipas Policisë edhe ngritja e çmimit të substancave ilegale narkotike në tregun e zi është një tregues i rëndësishëm që i pohon pretendimet e këtij institucioni për suksesin e madh në luftën kundër trafikimit të këtyre substancave.⁶²

Ajo cka vlen të theksohet, gjatë këtyre operacioneve të policisë përveç kapjes së sasive të mëdha të drogave është konfiskimi i sasive të konsiderueshme edhe të armëve, parave dhe automjeteve të përdorura për trafikim.⁶³ Rezultatet e tilla kanë bërë që të vërehet një rritje e theksuar e deklaratave për shtyp e zyrtarëve të Policisë dhe MPB-së në kapjen e trafikantëve të drogës dhe substancave të drogës.⁶⁴ Megjithatë, në raste të caktuara vërehet se rritja e përpjekjeve për luftimin e kontrabandës së drogës është bërë në kontekstin e nevojës për të arritur rezultate konkrete në prag të proceseve integruese. Prandaj është tejet e rëndësishme që të arriturat për luftën kundër kontrabandës të drogës të mos jenë krejtësisht të nxitura nga jashtë si rezultat i përpjekjeve për plotësimin e kushteve te parapara ne kuadër te procesit te

⁵⁶ Ibid:

⁵⁷ Ibid:

⁵⁸ Shiko Tabelën 3 me poshtë

⁵⁹ Qendra Evropiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga, Përmbledhje Shtetërore: Kosova, kontrollimi i fundit 2 shtator 2012, <http://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overviews/xk#dro>

⁶⁰ QKSS Intervistë me kapiten Bahri Shala, Policia e Kosovës, Departamenti Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 25 korrik 2012

⁶¹ Ibid:

⁶² Shiko Tabelën 3 me poshtë

⁶³ Shiko Tabelën 4 me poshtë

⁶⁴ Policia e Kosovës arrestoi pesë persona dhe konfiskoi 300 kilogramë narkotikë, Policia e Kosovës, 6 korrik 2012 <http://www.kosovopolic.com/?page=1,26,2616>

liberalizimit te vizave, por që përpjekjet e tilla të jenë të nxitura në radhë të parë nga nevoja për forcimin e rendit dhe ligjit në vend.

Është me rëndësi të theksohet se rezultatet në luftën kundër trafikimit të drogës janë bërë pavarësisht pamundësisë së Kosovës për tu anëtarësuar në nismat dhe rrjetet rajonale. Përderisa Kosova vazhdon të mbetet jashtë këtyre iniciativave, çdo sukses në luftimin e këtyre sfidave kryesisht është bërë në nivel lokal ndërsa është më se e ditur se luftimi i kontrabandës së drogës është një problem më tepër rajonal dhe më gjerë. Gjithashtu, zyrtarët kanë raportuar për mungesën e bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me institucionet policore ndërkombëtare si Europol, Interpol dhe Eurojust gjë që edhe më tepër i ka vështirësuar përpjekjet institucionale në luftimin e aktiviteteve respektive të krimit të organizuar.⁶⁵ Për të arritur progres në këtë drejtim, PK ka krijuar tashmë Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit i cili synon të rrisë bashkëpunimin bilateral dhe multilateral me institucionet e tjera të policisë.

Tabela 3: Statistikat të siguruara nga Policia e Kosovës në lidhje me hetimin e rasteve të trafikimit të drogës në Kosovë gjatë katër viteve të fundit.⁶⁶

Statistikat ndër vite	Lloji i Hetimit		Nacionaliteti			Gjinia		Lloji i Dyshimeve		
	Rastet e Hapur	Rastet e Dyshuara	Shqiptarë	Serb	Të tjerë	Meshkuj	Femra	Trafikim	Posedim	Kultivimi i Drogës
2009	272	414	393	5	16	391	23	90	147	35
2010	313	463	419	22	22	448	15	125	146	42
2011	407	547	507	13	27	529	18	143	234	53
2012	285	476	426	13	37	460	16	86	200	4
Totali	1277	1900	1745	64	102	1828	72	444	727	134

Tabela 4: Sasia e drogës e kapur nga Policia e Kosovës gjatë 2011/2012:⁶⁷

⁶⁵ Intervistë me Kolonel Shaban Guda, Drejtorja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), Policia e Kosovës, 27 gusht 2012

⁶⁶ Tabela dhënë nga Policia e Kosovës, 25 korrik 2012

⁶⁷ Tabela dhënë nga Policia e Kosovës, 25 korrik 2012

Konfiskimet	Heroin KG	Marinuanë KG	Kokainë KG	Farë Kanabis	Bimë Kanabisi	Ekstazë	Të tjera Kg	Armët	Para	Vetura
2011	33 12	89.62	2. 55	0	276	691	3068.4	14	9425€	17
2012	51.01	1000.84	7.21	6316	8098	153	256	43	60630€	30
Diferenca në:	17.89	911.22	4.66	6316	7822	-538	2812.4	22	51205€	13
Diferenca në %:	54%	1016%	183%	100%	2929%	78%	-92%	157%	543%	76%

B. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KORRUPSIONIT NË KOSOVË

Korrupsioni është një nga fenomenet shumë të përhapur që ndikon mjaft negativisht në funksionimin e sektorit publik, jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë Ballkanin Perëndimor. Duke qenë në mes të periudhës tranzitive, Kosovës i duhet bërë ende punë dhe i nevojitet përkushtim shtesë për të përfunduar reformat e rëndësishme institucionale që kanë të bëjnë me luftimin e këtij fenomeni në mënyrë që të përmbushë kriteret e integritetit Evropian. Prandaj nevojitet progres i konsiderueshëm për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin, ku qeveria tashmë duhet të sprovtoj seriozitetin e saj në trajtimin e kësaj çështjeje.

KORNIZA LIGJORE

Sa i përket miratimit të legjislacionit, korniza ligjore në fushën e luftimit dhe parandalimit të korrupsionit është relativisht e kompletuar, gjë që ishte potencuar edhe në vet Studimin e posa-publikuar të Fizibilitetit të Komisioni Evropian për Kosovën.⁶⁸ Në fakt, shumica e legjislacionit në këtë fushë është miratuar apo rimiratuar gjatë dy viteve të fundit. Ligji i ri për Agjencinë Kundër Korrupsionit hyri në fuqi në Janar të vitit 2010. Ky ligj hapi rrugën për nxjerrjen njëherësh edhe të ligjeve tjera përcjellëse të lidhura me këtë fushë, duke përfshirë: "Ligji për Deklarimin e Origjinës, dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe gjithashtu Deklarimi i dhuratave për të gjithë Zyrtarët Publik"⁶⁹; "Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik";⁷⁰ Ligji për Financimin e Partive Politike;⁷¹ Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe Ligji për Mbrojtjen e Informatorëve;⁷².

⁶⁸ Komunikata e Komisionit në Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës,

Komisioni Evropian, Bruksel, 10 tetor 2012, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf

⁶⁹ Ligji për Deklarimin e Origjinës, dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe gjithashtu Deklarimin e Dhuratave për të gjithë zyrtarët publik, Kuvendi i Kosovës, Fletorja Zyrtare, 14 shtator 2011

⁷⁰ Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike, Kuvendi i Kosovës, Fletorja Zyrtare, 14 shtator 2011

⁷¹ Ligji për Financimin e Partive Politike, Kuvendi i Kosovës, 6 tetor 2010, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-174-eng.pdf>

⁷² Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 31 gusht 2011, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Law%20on%20public%20procurement.pdf>

Përveç miratimit të këtyre ligjeve, korniza ligjore në këtë fushë pritet të plotësohet edhe me ligje tjera tejet të rëndësishme siç është Kodi i ri Penal që do të hyjnë në fuqi duke filluar nga Janari 2013. Kodi i ri Penal do të forcojë edhe më tutje përpjekjet institucionale në luftën e fenomenit të korrupsionit. Ndryshe nga Kodi i mëparshëm, Kodi i ri Penal përmban një kapitull të plotë i cili ndëshkon zyrtarët e korruptuar dhe aktet e tjera penale që lidhen me detyrën zyrtare.⁷³ I vetmi ligj i rëndësishëm që nuk është miratuar ende është "Ligji mbi Zgjatjen e Fuqive për Konfiskimin e Pasurive të Fituara duke kryer Vepër Penale", i cili ka qenë mjaft diskutabil dhe ka një kohë të gjatë që kur ky draft-ligj është duke qarkulluar nëpër Komisionet përkatëse të Kuvendit të Kosovës.⁷⁴ Përndryshe, legjislacioni i miratuar për anti-korrupsion në përgjithësi është në përputhje me të ashtuquajturat Acquis të BE-së dhe si rrjedhojë paraqet bazat e mjaftueshme ligjore për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit të zyrtarëve të lartë institucionalë.

Krahas përpjekjeve për plotësimin e kornizës ligjore në fushën anti-korrupsion, ka pasur ecuri edhe në përcaktimin e politikave institucionale për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e korrupsionit në vend. Kështu, gjatë 3 viteve të kaluara, Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2009-2011 të miratuara nga Kuvendi i Kosovës shërbyen si dokumente kryesore për përcaktimin e politikave institucionale në përpjekjet për të parandaluar dhe luftuar fenomenin e korrupsionit në Kosovë. Kjo strategji kishte për synim të reduktoj fenomenin e korrupsionit në institucionet qeveritare dhe të administratës publike në përgjithësi. Megjithatë, në aspektin cilësor kjo strategji ishte kritikuar mjaft nga akterë të ndryshëm të shoqërisë civile të përfshira në mbikëqyrjen e korrupsionit. Shqetësimet kryesore të tyre bazoheshin në faktin se gjatë vlerësimeve që ata i kishin bërë kësaj strategjie kishin vërejtur që afati kohor për zbatimin e aktiviteteve nuk ishte planifikuar mirë dhe se kostoja financiare e paraparë për implementimin e tyre nuk ishte në përputhje me aktivitetet e planifikuara. Po ashtu, kishte shqetësime që kjo strategji ka pasur si qëllim (në njëfar mënyre) të kufizonte rolin e Agjencisë Kundër Korrupsionit në mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë.⁷⁵

Pavarësisht këtyre kritikave, deri më momentin e nxjerrjes së strategjisë së re kjo strategji vazhdon të jetë aktive si platforma kryesore për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Megjithatë duke pasur parasysh që kjo strategji ka skaduar, strategjia e re e titulluar "Strategjia Nacionale dhe Plani i Veprimit kundër Korrupsionit 2012-2016" është në procesin e finalizimit. Strategjia e re synon të mbulojë një periudhë më të gjatë kohore, pra periudhën prej 5 viteve. Megjithatë përmbajtja e draftit të kësaj strategjie të re është më e avancuar në krahasim me strategjine ekzistuese, Studimi i Fizibilitetit i publikuar së fundi nga ana e Komisionit Evropian potencoi shqetësime në lidhje me përmbajtjen e kësaj strategjie, gjë që njëkohësisht mund të thuhet se kjo është një nga arsyet për vonesat në miratimin e saj.⁷⁶

⁷³ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Fletorja Zyrtare, 20 prill 2012 <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>

⁷⁴ Shih Projektligjin për Zgjatjen e Fuqive për Konfiskimin e Pasurive të Fituara nga Kundërvajtje penale, Kuvendi i Kosovës (2012/11/10): <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-140.pdf>

⁷⁵ *Dobësitë e Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2009-2011*, Lëvizja FOL, Faqe 4, 2010, http://levizjafol.org/images/uploads/files/Hulumtim_Politikash_Dobesite_e_Strategjise_Kunder_Korrupsion_dhe_Plani_i_Veprimit_2009-2011.pdf

⁷⁶ Komunikata e Komisionit në Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës, Komisioni Evropian, Bruksel, 10 tetor 2012, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf (faqe 10)

PARANDALIMI

Në përgjithësi, implementimi i strategjisë aktuale për anti-korrupsion ka hasur në përparim më të theksuar kur bëhet fjalë për ndërmarrjen e masave parandaluese. Gjatë dy viteve të fundit janë krijuar mekanizma të ndryshme për anti-korrupsion të cilat kanë më tepër rol strategjik si p.sh Task-Forca Anti-Korrupsion e cila është themeluar nga Qeveria si dhe Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit (i themeluar nga Presidenti). Si Task Forca ashtu edhe Këshilli kanë për qëllim koordinimin dhe forcimin e përpjekjeve institucionale në parandalimin e korrupsionit, ku në një mënyrë apo tjetër, këtë detyrë e ushtron edhe Agjencia Kundër-Korrupsionit. Prandaj, kjo ka ndikuar që edhe Këshilli edhe Task Forca janë kritikuar mjaft nga akterë të ndryshëm të shoqërisë civile, duke cilësuar veprimet për krijimin e këtyre mekanizmave më tepër si përpjekje për të futur nën kontroll Agjencinë Kundër-Korrupsionit, se sa si përpjekje për të kontribuar realisht në parandalimin dhe luftimin e fenomenit të korrupsionit.⁷⁷

Përveç krijimit të mekanizmave institucionale për të parandaluar korrupsionin, kohëve të fundit janë ndërmarr edhe disa masa të tjera të rëndësishme preventive siç është p.sh deklaratimet e pasurisë nga zyrtarët e lartë e që kohëve të fundit ishin botuar në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë Anti-Korrupsion. Ndërkohë, kundër gjithë atyre që refuzuan të deklarojnë pasuritë janë të iniciuar procedurat përkatëse gjyqësore.⁷⁸ Megjithatë, edhe në këtë rast ka pasur dyshime në lidhje me angazhimin e institucioneve përkatëse për të filluar procedurat kundër zyrtarëve të lartë të cilët refuzuan të deklarojnë pasuritë. Kjo për faktin se pavarësisht se në kohën e fundit në të gjitha Gjykatat e Qarkut u emëruan prokurorët të rinj speciale për të hetuar çështjet e korrupsionit të zyrtarëve të lartë publikë, niveli i individëve të dënuar për afëra korruptive mbetet relativisht i ulët.⁷⁹

Kohët e fundit ka pasur disa hapa konkrete drejt forcimit të kapaciteteve institucionale në luftën kundër korrupsionit. Tanimë, Policia e Kosovës ka konsoliduar plotësisht departamentin e saj të specializuar për Anti-korrupsion (SDAC), i cili synon përmirësimin e efikasitetit të policisë në luftën kundër fenomeneve të korrupsionit.⁸⁰ Po ashtu u bë emërimi i një koordinator për anti-korrupsion në Zyrën e Prokurorit të Shtetit, si dhe u caktua një prokuror i veçantë në zyrat e Prokurorive të Qarkut të cilët do të mirren specifikisht me rastet e korrupsionit. Gjithashtu, ka pasur hapa konkretë në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve. Rritja e pagave të gjyqtarëve dhe përfundimi i procesit të riemërimit u shënuan si hapa të mëtejshëm për të parandaluar korrupsionin në gjyqësor.⁸¹

LUFTIMI

Në anën tjetër, sa i përket hetimit të rasteve konkrete të korrupsionit, opinionet janë më të ndara dhe persimiste. Deri më tani, numri i rasteve të iniciuara për hetim kundër zyrtarëve të lartë për kryerjen e akteve korruptive ka qenë mjaft i vogël, ndërkohë që numri i individëve të dënuar për kryerjen e

⁷⁷ Për më shumë, ju lutem shikoni artikullin publikuar nga Koha Ditore më 1 Janar 2012

:<http://www.kohaditore.com/index.php/repository/.../Binder1.pdf?page=1,13,82576>

⁷⁸ Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian, Qeveria e Kosovës, Dhjetor 2011, http://www.mei-ks.net/repository/docs/Plani_i_veprimit_te_Partneritetit_Evropian_2012.pdf

⁷⁹ Raporti Vjetor 2011, Policia e Kosovës, Publikuar në 2011 http://www.kosovopolice.com/repository/docs/RAPORIT_I_PK-SE.pdf

⁸⁰ Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian, Qeveria e Kosovës, Dhjetor 2011, http://www.mei-ks.net/repository/docs/Plani_i_veprimit_te_Partneritetit_Evropian_2012.pdf

⁸¹ Kosova 2011 Raporti i Progresit, Komisioni Evropian, 12 tetor 2011

,http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf

korrupsionit është krejtësisht simbolik. Megjithatë, duke pasur parasysh që korrupsioni është i lidhur shpesh me krimin e organizuar ose të paktën përfshin një grup njerëzish të organizuar në kryerjen e tij, padyshim hetimi i çështjeve të korrupsionit mbetet çështja më sfiduese për gjyqësorin.

Sa i përket hetimeve, një numër i madh i rasteve tashmë janë iniciuar si nga Policia ashtu edhe nga ana Agjencisë Kundër Korrupsionit. Departamenti i specializuar për Anti-korrupsion (SDAC) brenda PK gjatë periudhës Prill 2010 – Dhjetor 2011 ka regjistruar 47 raste.⁸² Në anën tjetër, Agjencia Kundër Korrupsionit, e cila është agjenci udhëheqëse për anti-korrupsion në Kosovë, gjatë vitit 2011 ka hetuar gjithsej 160 raste që ndërthenin të gjitha elementet themelore për të filluar procedurat hetimore. Nga ky numër i përgjithshëm i rasteve të nisura nga Agjencia, 12 raste janë iniciuar ndaj gjyqtarëve dhe personelin tjetër të Gjykatave, 30 raste për zyrtarë qeveritarë, 56 raste për zyrtarët e pushtetit lokal, dhe 3 raste të tjera ishin kundër zyrtarëve të prokurorisë. Megjithatë, për procedurë të mëtutjeshme penale tek autoritetet kompetente shkuan vetëm 39 prej tyre, nga një total prej 121 persona të dyshuar që janë të përfshirë në këto afere korruptive.⁸³ Që nga janari 2009, tridhjetë vendime kundër krimeve të korrupsionit janë lëshuar nga panele të përziera të gjyqtarëve të EULEX-it dhe gjyqtarëve të Kosovës, ku tridhjetë të pandehur u gjetën fajtorë, ndërsa nëntë janë liruar. Nga rastet e tjera të korrupsionit, 216 raste janë të trashëguara nga vitet e mëparshme dhe 92 janë raportuar në periudhën Tetor 2010 – Korrik 2011.

Gjithashtu, gjatë vitit 2012 janë regjistruar një numër i madh i rasteve të individëve të arrestuar dhe të hetuar për afere korruptive. Gjatë këtij viti, rastet më të bujshme ishin arrestimi i 4 oficerëve të Policisë gjatë muajit Mars⁸⁴, arrestimi i shefit të Task-Forcës Anti-Korrupsion i cili ndodhi në muajin Prill 2012⁸⁵, hetimi i 8 gjyqtarëve dhe 1 prokurori nga policia e EULEX-it⁸⁶, si dhe raste të tjera që tregojnë se ka një rritje të dukshme të gatishmërisë institucionale në luftën kundër korrupsionit dhe atë në kuadër të sferave më të rëndësishme të administratës publike .

C. PARANDALIMI DHE LUFTIMI KUNDËR TERRORIZMIT

Vlerësimet mbi rreziqet dhe kërcënimet e bera deri tani nuk kanë identifikuar terrorizmin si kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë Kosovë. Kjo pasi që deri më tani nuk ka pasur kërcënime serioze nga terrorizmi global i cili është drejtuar kundër qytetarëve apo shtetit të Kosovës ose kundër personelit ndërkombëtar që punojnë për misionet ndërkombëtare të vendosura këtu. Mungesa e përfshirjes së Kosovës, qoftë edhe në nivel simbolik, në luftën globale kundër terrorizmit e shkakton për shkak të mungesës së forcës ushtarake teknikisht ka pamundësuar që Kosova të ju bashkëngjitet proceseve të rëndësishme të sigurisë globale. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Kosova ka neglizhuar tërësisht potencialin kërcënues që paraqet

⁸² Raporti Vjetor 2011, Policia e Kosovës, Publikimi në vitin 2011 http://www.kosovopolice.com/repository/docs/RAPORIT_I_PK-SE.pdf

⁸³ Raporti Vjetor 2011 (Janar-Dhjetor), Agjencia Anti-Korrupsion, Botuar në vitin 2012 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Annual-Report-2011-ACA-fv.pdf>

⁸⁴ Shiko artikullin nga Balkan Insight “ <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-police-arrests-4-pdk-senior-officials-in-vushtri-municipality>

⁸⁵ Shiko "Shefi i Task-forcës Anti-korrupsionit u arrestua për korrupsion", 4 prill 2011, http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/04/04/feature-03

⁸⁶ Shiko artikullin "EULEX akuzon 8 gjyqtarë dhe 1 prokuror për Korrupsionin", Zëri i Amerikës, <http://www.zeriamerikes.com/content/kosove-tete-gjyqtare-te-akuzuar-per-korrupsion/1450112.html>

terrorizmi, duke pasur parasysh që gjatë dekadës së fundit fenomeni i terrorizmit global është përhapur pothuajse në gjithë botën, duke mos kursyer pothuajse asnjë vend apo rajon.

KORNIZA LIGJORE

Nga pikëpamja ligjore, deri më tani aktet e terrorizmit kanë qenë të dënueshme kryesisht me Kodin e Përkohshëm Penal i cili përmbante sanksione të ashpra për personat që kryejnë vepër penale të ndërlidhura me terrorizmin, duke përfshirë financimin dhe mënyra të tjera të mbështje së akteve të tilla.⁸⁷ Ndërkohë, Kodi i ri Penal (i cili do të hyjë në fuqi në Janar 2013) ka përmirësuar edhe më tej masat ndëshkuese kundër akteve terroriste duke forcuar dispozitat që rregullojnë ndëshkimin e akteve të terrorizmit, si dhe financimin e mjete të tjera mbështetëse të parashikuara për këtë dukuri. Ndër tjera, Kodi i ri Penal ka rritur edhe dënimin kundrejt kryesve të akteve terroriste.⁸⁸

Po ashtu, është vërejtur edhe nxjerrja e disa ligjeve të tjera përcjellëse të ndërlidhura me këtë fushë, si: ligji i MIK-ut (i cili synon të forcojë kontrollin kufitar si një çelës për të parandaluar përhapjen e aktiviteteve terroriste në territorin e Kosovës); Ligji për të Huajt dhe Azilin (i cili synon të modernizojë procesin për individët që kërkojnë azil apo statusin e huaj rezident në Kosovë, duke e lehtësuar punën e PK-së për të zbuluar identitetin e të huajve të cilët paraqesin probleme terroriste); si dhe Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit⁸⁹ i cili u miratua në vitin 2010, i cili ka përmirësuar dukshëm kornizën ligjore sidomos në lidhje me financimin e aktivitetet kriminale që lidhen me financimin e terrorizmit.

PËRSHTATJA E STRATEGJIVE

Përveç nxjerrjes së legjislacionit, Qeveria e Kosovës ka miratuar strategji të ndryshme në sektorit të sigurisë të cilat përfshijnë edhe disa aspekte shumë të rëndësishme të parandalimit dhe luftimit të terrorizmit. Ndër dokumentet e rëndësishme strategjike, ku janë përfshirë masa të rëndësishme kundër terrorizmit është edhe Strategjia e Sigurisë së Kosovës, dokument i cili u kritikua mjaft për shkak të mos-reflektimit të nevojave dhe kontekstit vendor si rezultat i insistimeve nga disa akterë ndërkombëtarë. Për më tepër, përmbajtja e kësaj strategjie kurr nuk është bërë publike, duke ngritur spekulime të ndryshme në lidhje me përmbajtjen e saj. Megjithatë, strategjitë e tjera të cilat mbulojnë këtë fushë e të cilat janë bërë publike, si *Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Terrorizmit 2009–2012*, Strategjia e IBM dhe Strategjia kundër korrupsionit, të cilat ofrojnë bazë të kënaqshme për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin në vend. Strategjia e Kosovës kundër Terrorizmit ka përfshirë pesë nivelet e veprimeve kundër terrorizmit, duke filluar që nga parandalimi, kërkimi, mbrojtja, përgatitja dhe reagimi.⁹⁰

IMPLEMENTIMI

Përveç kompletimit të kornizës politike dhe strategjike, në kuadër të kësaj fushe ka pasur edhe konsolidim të institucioneve dhe mekanizmave institucionale të ngarkuara për parandalimin dhe luftimin e terrorizmin në Kosovë. Një nga hapat më të mëdhenj në këtë drejtim është konsolidimi i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë (AKI). Sipas zyrtarëve të saj, kjo Agjenci kryen funksione operacionale, që do të thotë se

⁸⁷ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Neni 105, Kuvendi i Kosovës dhe UNMIK-ut, 6 Qershor 2003,

http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2003regs/RA2003_25_CCintranet.pdf

⁸⁸ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Neni 135, Kuvendi i Kosovës, Fletorja Zyrtare, 20 prill 2012 <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>

⁸⁹ Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Kuvendi i Kosovës, 18 tetor 2010, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-196-eng.pdf>

⁹⁰ Republika e Kosovës Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit kundër Terrorizmit, Qeveria e Kosovës, Prishtinë, Qershor 2009 http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strat_Terror_Eng.pdf

Kosova posedon një institucion që mbledh dhe analizon informata në lidhje me aktivitetet e mundshme terroriste kundër qytetarëve, shtetit të Kosovës dhe personave të tjerë të pranishëm në Kosovë. Progres i rëndësishëm është identifikuar në lidhje me inteligjencën financiare dhe në fushën e pastrimit e parave. Për të rritur rolin e inteligjencës financiare, Qeveria e Kosovës ka transformuar Njësinë e Inteligjencës Financiare (FIU) në agjenci të re të quajtur Task-Forca e Veprimit Financiar. Ndër aktivitetet kryesore të ushtruara nga kjo agjenci janë hetimet në lidhje me transaksionet në vlera më të mëdha se 10.000 euro, transaksionet e dyshimta dhe transaksionet e strukturuar.⁹¹ Ngjajshëm, edhe Policia e Kosovës ka promovuar së fundi Njësinë e Anti-terrorizmit në Departamentin e Kundër Terrorizmit, gjë që tregon se terrorizmi po trajtohet seriozisht nga institucionet qeveritare. Sipas disa burimeve, në përgjithësi ky departament i ri konsiderohet të jetë operacional veçanërisht në nivelin e inteligjencës, megjithatë ende ka nevojë për të zhvilluar edhe më tej marrëdhëniet bashkëpunuese me agjencitë relevante qeveritare si dhe me komunitetet fetare këtu.⁹²

Bashkëpunimi rajonal në luftën kundër terrorizmit është një tjetër segment i rëndësishëm për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në shkallë të madhe. Megjithatë, duke pasur parasysh mungesën e njohjes së shtetësisë nga organizata kyçe rajonale dhe ndërkombëtare të sigurisë dhe drejtësisë, kjo temë është shumë e gjerë dhe e komplikuar, prandaj duhet të trajtohet në një studim të veçantë dhe si rrjedhojë nuk do të jetë pjesë e këtij punimi. Ndërsa, kur është fjala për veriun e Kosovës, vlen të theksohet se përkundër të gjitha sfidave që institucionet e Kosovës janë duke u përballur atje në lidhje me zbatimin e rendit publik dhe politikat e sigurisë, për shkak të ndjeshmërisë së saj politike dhe përfshirjes së gjerë të bashkësisë ndërkombëtare (EULEX dhe KFOR) deri më tani kjo çështje është trajtuar në mënyrë të izoluar, pra vetëm në kuadër të dialogut teknik të ndërmjetësuar nga BE në mes të Kosovës dhe Serbisë. Më konkretisht, deri më tani, BE-ja deri më tani ka bërë të qartë se situata në veri të Kosovës mund të ketë pasoja negative të drejtpërdrejta ose të tërthorta të cilat do mund të ndikonin në dialogun e strukturuar për liberalizimin të vizave me Kosovën. Prandaj, duke pasur parasysh mungesën e ndërlidhshmërisë në mes të procesit të liberalizimit të vizave dhe situatës në veri të Kosovës, kjo çështje nuk do të jetë objekt i këtij studimi.

BIBLIOGRAFIA

⁹¹ Shtetet e Bashkuara - Departamenti i Shtetit, Raportet e shtetit mbi Terrorizmin 2011 - Kosovë, 31 korrik 2012, në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/501fbc0c.html> [e mare me 12 September 2012]

⁹² Shtetet e Bashkuara - Departamenti i Shtetit, Raportet e shtetit mbi Terrorizmin 2011 - Kosovë, 31 korrik 2012, në: <http://www.unhcr.org/refworld/docid/501fbc0c.html> [e mare me 12 September 2012]

i. Intervistat

1. QKSS intervistë me Arben Pacarrizi, Policia e Kosovës, Departamenti kundër Trafikimit të Drogës, 25 Korrik 2012
2. QKSS intervistë me Behar Selimi, Ish-drejtor i Policisë së Kosovës, aktualisht Deputet i Kuvendit të Kosovës, 11 Qershor 2012
3. QKSS intervistë me Captain Bahri Shala, Policia e Kosovës, Departamenti kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 25 Korrik 2012
4. QKSS intervistë me Col. Shaban Guda, Drejtorja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK), Policia e Kosovës, 27 Gusht, 2012
5. QKSS intervistë me Lutfi Haziri, Deputet në Kuvendin e Kosovës, Kryetar i Komisionit për Integritet Evropian, 27 Qershor 2012
6. QKSS intervistë me Fatmir Xhelili, Ish-Zëvendës-Ministër i Punëve të Brendshme (2007-2010), aktualisht Deputet i Kuvendit të Kosovës dhe gjithashtu anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, 14 Qershor 2012
7. QKSS intervistë me Peter Achtelik, Njësia e Krimit të Organizuar, Policia EULEX, 13 Korrik 2012
8. QKSS intervistë me Rifat Marmallaku, Ish-Kolonel i Policisë së Kosovës, Analist i Pavarur për Politikën e Sigurisë, 13 Qershor 2012
9. QKSS intervistë me Karin Marmsoler, *Këshilltar Politik – Sundimi i Ligjit*; Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Prishtinë, 29 Qershor 2012

ii. Legjislacioni

10. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Art 135, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 20 Prill 2012
<http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Kodi%20penal.pdf>
11. Projektligji për Zgjatjen e Fuqive për Konfiskimin e Pasurive të Fituara nga Kundërvajtjet Penale, Kuvendi i Kosovës (kontrolli i fundit 11.10.2012): <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-140.pdf>
12. Ligji për Azil-kërkuesit, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare 21 12 2011
<<http://kuvendikosoves.org/?cid=2,191,819>>
13. Ligji për Deklarimin e Origjinës, dhe Kontrollin e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe gjithashtu Deklarimin e Dhuratave për të gjithë Zyrtarët Publik, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 14 Shtator 2011
<<http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-151-eng.pdf>>
14. Ligji për Financimin e Subjekteve Politike, Kuvendi i Kosovës, 6 Tetor 2010, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-174-eng.pdf>
15. Ligji për të Huajt, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 21 Dhejtor 2011<<http://kuvendikosoves.org/?cid=2,191,816>>

16. Ligji për Menaxhimin e Integruar dhe Kontrollin e Kufijve Shtetëror, Kuvendi i Kosovës, 15 Qershor 2008, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L065_en.pdf
17. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funkcioneve Publike, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 14 Shtator 2011 <http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2007_02-L133_en.pdf>
18. Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 31 Gusht 2011, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20public%20procurement.pdf>
19. Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave Pyetëtori Financimit të Terrorizmit, Kuvendi i Kosovës, 18 Tetor 2010, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-196-eng.pdf>
20. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, Art 105, Kuvendi i Kosoves & UNMIK, 6 Qershor 2003, http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2003regs/RA2003_25_CCintranet.pdf
21. Kodi i Përkohshëm Penal, Kuvendi i Kosovës, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, http://www.unmikonline.org/regulations/2003/RE2003_25_criminal_code.pdf

iii. Strategjite dhe Dokumentet e tjera

22. ‘*Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit i Republikës së Kosovës kundër Krimit të Organizuar*’ (2009–2011), Qeveria e Kosovës, Qershor 2009 <http://www.mpb-ks.org/repository/docs/ENG_STRATEGJIA_KKT_30_QERSHOR.pdf>
23. “*Marrëveshjet me vendet e Ballkanit Perëndimor për lehtësimin e lëshimit të vizave*”, Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, 8 Nenore 2007, http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/ëestern_balkans/114578_en.htm
24. “*Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në (2008–2011)*”, Ministria e Punëve të Brendshme, 2008
25. “*Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në (2011–2014)*”, Ministria e Punëve të Brendshme, 2011
26. “*Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në (2008–2011) & (2011–2014)*”, Ministria e Punëve të Brendshme, <<http://www.mpb-ks.org/repository/docs/TQNJShqip.pdf>>
27. “*Republika e Kosovës Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit kundër Terrorizmit*”, Qeveria e Kosovës, Prishtinë, Qershor 2009 http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strat_Terror_Eng.pdf
28. *Strategjia Kombëtare e Anti-drogës dhe Plani i Veprimit (2009–2012)*, Ministria e Punëve të Brendshme, Qershor 2009, <http://www.mpbks.org/repository/docs/strategjia_16_06_09_finale_kombetare_ENG.pdf>

29. *Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të kufirit (1999–2012)*, Qeveria e Kosovës, Prill 2012, http://www.mpb-ks.org/repository/docs/Strategjia_Anglisht_FINAL_National_strategy_of_the_Republic_of_Kosovo_2009.pdf
30. *Marrëveshjet e Ripranimit me vendet e Ballkanit Perëndimor*, Këshilli i Evropës, Komisioni Evropian, 8 Nëntor 2007 http://europa.eu/legislation_summaries/enlargement/ëestern_Balkans/114562_en.htm
31. *Agjenda e Selanikut*, European Council, 15 June 2003, http://ec.europa.eu/enlargement/enlargement_process/accesion_process/hoë_does_a_country_join_the_eu/sa/p/thessaloniki_agenda_en.htm (kontrollimi i fundit: 29 Qershor 2012)
32. *Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave me: Shqipërinë, Bosnja & Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia*, 2009

iv. Raportet vendore dhe nderkombetare, dhe aritukujt

33. *Raportet e Shtetit mbi Terrorizmin 2011 – Kosova, Shtet e Bashkuara Departamenti i Shtetit*, 31 Korrik 2012, ne dispozicion ne: <http://www.unhcr.org/refëorld/docid/501fbc0c.html> [qasja e fundit i 12 Shtator 2012]
34. “2012 Trafikimi i Personave – Kosova ”, Shtetet e Bashkuara Departamenti i Shtetit, 19 Qershor 2012 <http://www.unhcr.org/refëorld/country,,USDOS,,SRB,,4fe30cb832.0.html>
35. “*Raporti Vjetor 2011 (Janar – Dhjetor)*”, Agjencia Anti-Korrupsion, 2012 <http://www.akk-ks.org/repository/docs/Annual-Report-2011-ACA-fv.pdf>
36. “*Komunikata e Komisionit në Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës*”, Komisioni Evropian, 10 Tetor 2012 http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/ks_analytical_2012_en.pdf
37. “*Përmbledhje shetërore: Kosove 2011*”, Qendra Europiane e Monitorimit për Drogën dhe Varësinë nga Droga Verifikimi i fundit, 02 Shtator 2012, http://www.emcdda.europa.eu/publications/country-overvieës/_xk#dro
38. “*Raporti vjetor i Policisë se Kosovës 2011*”, Policia e Kosovës, 2011 http://www.kosovopolice.com/repository/docs/RAPORIT_I_PK-SE.pdf
39. *Përcaktimi i kufijve në Ballkanin Perëndimor, mes Perspektivën e Popullit, Saferëorld*, Tetor 2011, <http://www.saferëorld.org.uk/downloads/pubdocs/Draëing%20boundaries%20in%20the%20ëestern%20Balkans.pdf>
40. *Plani i Veprimit për Partneritet Evropian*, Qeveria e Kosovës, Dhjetor 2011, http://www.mei-ks.net/repository/docs/Plani_i_veprimit_te_Partneritetit_Evropian_2012.pdf
41. Raporti i Progresit për Kosovës 2011, Komisioni Evropian, 12 Tetor 2011, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2011/package/ks_rapport_2011_en.pdf
42. *Policia e Kosovës arreston 4 zyrtare të PDK-se*, Balkan Insight, Mars 6 2012 “ <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-police-arrests-4-pdk-senior-officials-in-vushtrri-municipality>

43. *MBROJTËSI*, Volume IV- Nr. 2, Policia e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Policisë së Kosovës, Maj 2008, <http://www.kosovopolice.com/repository/docs/internet.pdf>
44. *Dobësitë e Strategjisë Kundër Korrupsion dhe Planit të Veprimit 2009-2011*, Lëvizja FOL, 2010, http://levizjafol.org/images/uploads/files/Hulumtim_Politikash_Dobesite_e_Strategjise_Kundër_Korrupsion_dhe_Plani_i_Veprimit_2009-2011.pdf
45. *Lufta e Dështuar Kundër korrupsionit*, Artikull i publikuar në “Koha Ditore”, 1 Janar 2012, http://www.kohaditore.com/index.php/repository/.../Binder_1.pdf?page=1,13,82576

v. Artikuj Lajme

46. “*EULEX akuzon 8 gjyqtarë dhe 1 Prokuror për korrupsion*”, Zëri i Amerikës, <http://www.zeriamerikes.com/content/kosove-tete-gjyqtare-te-akuzuar-perkorrupsion/1450112.html>
47. “*Shefi i Task-Forcës për anti-korrupsionit i arrestuar për korrupsion*”, 4 Prill 2011, http://setimes.com/cocoon/setimes/xhtml/en_GB/features/setimes/features/2012/04/04/feature-03
48. Policia e Kosovës arrestoi pese persona dhe konfiskoi 300 kilogram substance narkotike, Policia e Kosovës, Komunikate për shtyp, 6 Korrik 2012, <http://www.kosovopolice.com/?page=1,26,2616>
49. Fjalimi i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, publikuar në ëeb-faqen zyrtare të Kuvendit të Kosovës, Qershor 2012 <<http://kuvendikosoves.org/?cid=1,184>>
50. “*Transkripti i Këshillit të Sigurimit të OKB, viti 67, mbledhja e 6822*”, Nju Jork, E martë, 21, Gusht 2012, <http://www.securitycouncilreport.org/atf/cf/%7B65BFCF9B-6D27-4E9C-8CD3-CF6E4FF96FF9%7D/Kos%20S%20PV%206822.pdf>